



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

RAPORTET E MONITORIMIT

8 - MUJORI VITI 2018

Programet Buxhetore:

1. Planifikim Administrim, Menaxhim
2. Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë
3. Arti dhe Kultura

RELACION

MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË KATËR MUJORIT TË VITIT

2018

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.109 datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”i ndryshuar, paragrafi V “Monitorimi” si dhe Udhëzimi nr.22 datë 17.11.2016 “Për Procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore” Ministria e Kulturës, për 8-mujorin e vitit 2018, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore.

Për vitin 2018 detajimi i buxhetit është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë. Por në zbatim të **aktit normativ nr.1 datë 26.07.2018, plani i buxhetit 2018 ka pësuar ndryshime të cilat paraqiten sipas tabelës më poshtë:**

në 000/lekë

Programet	Artikulli	Buxheti 2018	shtesa/pakesime sipas AN	Buxheti I Rishikuar 2018
Planifikim, Menaxhimi dhe Administrimi	Shpenzime personeli	115,276	(7,000)	108,276
	Shpenzime Korrente	45,000	-	45,000
	Shpenzime Kapitale	-	-	-
	Totali	160,276	(7,000)	153,276
Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	Shpenzime personeli	280,624	15,135	295,759
	Shpenzime Korrente	154,448	-	154,448
	Shpenzime Kapitale	200,000	(7,000)	193,000
	Totali	635,072	8,135	643,207
Arti dhe Kultura	Shpenzime personeli	541,600	3,500	545,100
	Shpenzime Korrente	222,949	-	222,949
	Shpenzime Kapitale	450,000	-	450,000
	Totali	1,214,549	3,500	1,218,049
TAVANET MK	Shpenzime personeli	937,500	11,635	949,135
	Shpenzime Korrente	422,397	-	422,397
	Shpenzime Kapitale	650,000	(7,000)	643,000
	TOTALI	2,009,897	4,635	2,014,532

Në mbështetje të Aktit Normativ, theksojmë se shpenzimet e personelit janë shtuar rreth **18,635 mijë lekë** nga totali i fondeve të kërkuara prej **31,352 mijë lekë**, (nga ku vlera prej **11,635 mijë lekë** është plotësuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe pjesa tjetër prej **7,000 mijë lekë** është plotësuar nga fondet e lira që ka deklaruar Ministria e Kulturës

në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim kjo si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante nga DAP për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018). Ndërsa shpenzimet kapitale janë pakësuar në vlerën prej **7,000 mijë lekë**.

Me ndryshimin e planit të vitit korrent janë bërë reflektimet e duhura në planin e produkteve në sasi dhe në vlerë për pjesën e mbetur të vitit për tu përshtatur me planin e ri. Më poshtë prezantojmë në mënyrë të detajuar informacionin mbi realizimin e buxhetit për **8 - mujorin e vitit 2018 referuar tashmë Planit të Rishikuar të Buxhetit për vitit 2018** , ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore

Nr	Emri i programit	Plani 8– mujori 2018		Realizimi 8– mujori 2018			Realizimi në (%) ndaj Buxhetit vjetor sipas Planit të Rishikuar
		Në (000) leke)	Struktura ne (%)	Në (000) leke	Struktura në (%)	Në (%) ndaj Planit 8-mujorit	
1.	Planifikim, Menaxhim, Administrim	96,053	7.4 %	83,396	7.2 %	86.8 %	54.4 %
2.	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	350,727	27.2 %	286,797	24.8 %	81.8 %	44.6 %
3.	Arti dhe Kultura	842,987	65.4 %	786,162	68 %	93.3 %	64.5 %
	Totali	1,289,767	100%	1,156,355	100%	89.7 %	57.4 %

Siç vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 89.7% ndaj planit të 8-mujorit 2018 dhe 57.4 % ndaj , ku rreth 68 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 93.3% ndaj planit të 8-mujorit 2018 dhe realizuar 64.5% ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar, ndjekur nga programi "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë" shpenzimet e të cilit zënë rreth 24.8 % dhe janë realizuar në masën 81.8 % ndaj planit të 8-mujorit 2018 dhe realizuar 44.6 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar ndërsa programi "Planifikim Menaxhimi Administrim” shpenzimet e të cilit zënë rreth 7.2 % të totalit dhe janë realizuar në masën 86.8 % ndaj planit të 8-mujorit 2018 dhe realizuar 54.4 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomikë

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 8-mujori 2018		Realizimi 8-mujori 2018		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj Planit 8-mujorit
12		600-601	Paga, Sig.Shoq	624,441	48.4 %	591,765	51.2 %	94.8 %
12		602-606	Shpen.Korrente	284,910	22.1 %	225,821	19.5 %	79.3 %
12		230-231	Shpen Kapitale	380,417	29.5 %	338,769	29.3 %	89.1 %
			TOTALI	1,289,767	100 %	1,153,355	100 %	89.7 %

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 89.7 % ndaj planit për 8 mujorin e 2018. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 48.4 % të totalit dhe janë realizuar në masën 94.8%. Shpenzimet korrente zënë rreth 22.1 % të totalit dhe janë realizuar në masën 79.3 %. Shpenzimet kapitale zënë rreth 29.5 % të totalit dhe janë realizuar në masën 89.1% ndaj planit për 8 mujorin e 2018.

Më poshtë po analizojmë realizimin e buxhetit sipas zërave dhe produkteve për çdo program buxhetor.

1.Programi: “PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM”

Për fondet e këtij programi, konstatohet planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 8-mujori 2018		Realizimi 8-mujori 2018			Realizimi në (%) ndaj Buxhetit vjetor sipas Planit të Rishikuar
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj Planit 8-mujorit	
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	65,933	68.6 %	55,730	84.5 %	96.6 %	51.5 %
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	30,120	31.4 %	27,666	33.2 %	91.9 %	61.5 %
12	01110	230-231	Shpen.Kapitale						
			TOTALI	96,053	100%	83,396	100%	86.8 %	54.4 %

Nga të dhënat konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 86.8 % ndaj planit të 8-mujorit 2018 dhe 54.4 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar, shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 68.6 % të totalit dhe janë realizuar në masën 96.6 % ndaj planit të 8-mujorit 2018 dhe 51.5 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar. Shpenzimet korrente zënë rreth 31.4 % të totalit dhe janë realizuar në masën 91.9 % ndaj planit të 8-mujorit 2018 dhe 61.5 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar. Ndërsa shpenzime kapitale nuk ka për vitin 2018.

Lidhur me realizimin e shpenzimeve korente sqarojmë :

-Përsa I takon shpenzimeve të personelit realizimi është i ulët si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante të aparatit të Ministrisë nga ana e DAP-it, fondet e lira për këtë zë i kemi deklaruar në Ministri të Ekonomisë dhe Financave, të cilat u pakësuan me aktin Normativ nr.1 datë 27.06.2018.

-Për shpenzimet korrente, realizimi arrin 61.5% sepse nga procedurat e prokurimeve deri te lidhja e kontratave, proces ky shtrihet në një hark kohor në 3-4 muajt e parë të vitit, sjell që realizimi për 8 mujorin të jetë pothuajse jo në nivelet e pritshme, por MK po merr masa për mbylljen e gjithë likuidimeve pasi të gjitha fondet në dispozicion janë të angazhuara.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në pesë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Kodi i Programit	01110	Emertimi i programit:	Planifikim, Menaxhim, Administrim							Komente
Qëllimi 1	Rritja e cilesise se punes; Perafrimi legjislacionit shqiptar me ate te BE-se per permbushjen e e kriterëve ne fushen e kultures qe rrjedhin nga MSA dhe asquis communautaire; Pershtatja e strukturave aktuale ne baze te objektivave te MK; Zbatimi i legjislacionit te fushes; Kontrolli dhe auditimi te struktures se Ministrise Kultures; Finalizimi i marreveshjeve dypalsh dhe protokolleve te bashkepunimit dhe pjesmarria e Shqiperise ne takime rajonale dhe nderkombetare									
***Treguesit e performancës/Produktet:										
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli i planifikuar per perioden progresive	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit		
Objektivi 1.1	Permisimi i legjislacionit ekzistues, hartimi i akteve te reja ligjore dhe nenligjore ne perputhje me programin e qeverise dhe detyrimeve qe rrjedhin nga MSA sipas fushes se veprimtarise se MK									
	G	Mirafitimi i legjislacionit dhe akteve ligjore ne zbatim te tij	47,518	57,652	57,652	36,558	48,359	132%	eshte tejkaluar planifikimi, jane miratur akte ligjore/nenligjore per te parashikimit te programit analitik per vitin 2018	
Objektivi 1.2	Ngritja e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese per stafin e MK per permbushjen me cilesi te raportimeve									
	H	Trajnime per stafin me qellim permbushjen me cilesi te raportimeve	32,900	46,763	46,763	26,500	22,480	85%		
Objektivi 1.3	Permisimi i kushteve te Punës per punonjesit e MK per permbushjen me cilesi te punes									
	M	Rinovimi te pajise egzistuese	1,492	-	-			#DIV/0!		
Objektivi 1.4	Respektimi i procedurave ligjore ne raport me te tretet dhe shlyerja ne kohe e detyrimeve gjyqesore									
	I	Zgjidhje e konflikteve me te tretet dhe shmangje e detyrimeve te prapambetura	26,923	6,100	6,100	4,067	-	0%	eshte duke u finalizuar perqilimi i detyrimeve permbledhës për vendimet gjyqësore të formuara në përputhje me sistemin e kulturës dhe parakalsh të shqyrtimit mundësia e ndonjë rielokimit për fonde që mund të rezultojnë të papërdorura përpara shlyerjes së vitit buxhetor me qëllim shlyerjen e vendimeve gjyqësore të parajgjura në mënyrë të mirë.	
Objektivi 1.5	Mirëmenaxhim dhe përdorim me efektivitet të fondeve buxhetore dhe reduktim të parregullsisë të konstatuara nëpërmjet auditimeve të brendshme									
	J	Zbatimi të legjislacionit në fuqi për Aparatin dhe Institucionet e varesive	32,800	36,997	29,997	20,728	5,384	26%	nuk është realizuar në nivelin e planifikuar për 8 mujorin: a) si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante në sek.auditit b) gjithashtu me ndryshimin e planit të vitit korent me AN 1.08 26.07.18 është rishikuar plani i produkteve në terma sasior dhe vleror	
Objektivi 1.6	Intensifikimi i bashkëpunimit rajonal dhe nderkombetar dhe promovimi i kultures dhe trashegimisë kulturore nepermyet fondeve dhe programeve te Bashkimit Evropian									
	K	Marreveshje bilaterale te nenshkruara dhe aplikime per thithej fondesh ne programet komunitare.	13,368	12,764	12,764	8,200	7,173	87%		

Nga sa më sipër rezulton se produktet e listuara nën këtë program janë realizuar sipas pritshmërive.

Për sa i përket **Produktit G** “Miratimi i legjislacionit dhe akteve ligjore në zbatim të tij” është realizuar pothuajse plotësisht sipas nivelit të planifikuar për 8-mujorin e 2018. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar këto akte ligjore/nënligjore bazuar në parashikimin e programit analitik për vitin 2018:

Nr.	Akti	Lloji i aktit	Miratuar/ Në proces
1.	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e integruar BSH/DATANLA të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë	Projektvendim	Miratuar me vendimin nr. 134 datë 7.3.2018
2.	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin ĒEBGIS për menaxhimin e veprimtarisë arkeologjike në terren të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik	Projektvendim	Miratuar me vendimin nr. 133 datë 7.3.2018
3.	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”	Projektvendim	Miratuar me vendimin nr. 278 datë 16.5.2018

Gjithashtu janë miratuar këto akte ligjore/nënligjore të pa parashikuara në programin analitik për vitin 2018:

Nr.	Akti	Lloji i aktit	Miratuar/ Në proces
1.	Për lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 11 veprave të piktorit të popullit Vangjush Mio, me qëllim ekspozimin e tyre në centro culturale Don Orione Artigianelli, Sala Tziano, dorsoduro 909/a – Venecia, Itali	Projektvendim	Miratuar me vendimin nr. 121 datë 28.2.2018
2.	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të pasurive nr. 8/638 dhe nr. 8/637, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8270, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 25, datë 9.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të pronave të paluajtshme të Bashkisë Tiranë”	Projektvendim	Miratuar me vendimin nr. 186 datë 29.3.2018
3.	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e aktiviteteve, pjesë të kalendarit për vitin 2018, si “Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”	Projektvendim	Miratuar me vendimin nr. 133 datë 7.3.2018
4.	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Teatrit Kombëtar.	Projektvendim	Miratuar me vendimin nr. 29 datë 17.1.2018
5.	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Galerisë Kombëtare të Arteve	Projektvendim	Miratuar me vendimin nr. 204 datë 11.4.2018
6.	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave	Projektvendim	Miratuar me vendimin nr. 326 datë 31.5.2018
7.	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, për sipërfaqen prej 235 m ² , të pasurisë me numër 1/256, me sipërfaqe totale 1644 m ² , me vendndodhje në zonën kadastrale 8150	Projektvendim	Miratuar me vendimin nr. 372 datë 20.6.2018

8.	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për themelimin e Qendrës Kulturore të Kinës në Shqipëri	Projektvendim	Miratur me vendimin nr. 417 datë 4.7.2018
9.	Për lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të veprës së artit në pikturë “Mbjellja e pemëve”, të autorit Edi Hila, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, e cila do të jetë pjesë e ekspozitës “Edi Hila Monography”, që organizohet në Muzeun e Artit Modern në Varshavë, Poloni	Projektvendim	Miratur me vendimin nr. 53 datë 31.1.2018
10.	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 795, datë 26.11.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përhershëm të vlerësimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe kriteret shkencore e procedurat e vlerësimit të këtyre objekteve”	Projektvendim	Miratur me vendimin nr. 306 datë 23.5.2018
11.	Për kthimin në atdhe të eshtrave të personalitetit të shquar të letrave shqipe dhe të kulturës mbarëkombëtare Mid’hat Frashëri”	Projektvendim	Miratur me vendimin nr. 485 datë 31.7.2018
12.	Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për themelimin e Qendrës Kulturore të Kinës në Shqipëri	Projektvendim	Miratur
13.	Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit godinës së re të Teatrit Kombëtar”	Projektligj	Miratur (kthyer nga presidenti)

Kurse **Produkti H** “Administratë Funktionale” është realizuar në masën 85 % nga niveli i planifikuar për 8-mujorin e 2018. Në këtë aspekt punonjësit e Ministrisë së Kulturës janë trajnuar për :

- Procesin e përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetimit Gjikor
- Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë
- Prezantimin e Udhëzimit të ri Standart të Përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm
- Pjesmarrje në Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale
- Ëorkshop për funksionalitetin e portalit E-regjistër
- Trajnim mbi zbatimin e procesit të vlerësimit të ndikimit (RIA)
- Trajnim i punonjësve mbi burimet Gjenetike, shprehjet tradicionale dhe folklori
- Trajnim mbi burimet Gjenetike, shprehjet tradicionale dhe folklori
- Trajnim për Sistemin e Menaxhimit elektronik të Dokumentave EDRMS
- Trajnim nga IFICO/ËBIF për procesin e NSPP/SSPP në Shqipëri
- Trajnim për menaxhimin e fondeve IPA të Asistencës Financiare të BE-s pranë ASPA-s
- Trajnimi ka zgjatur 15 ditë pune gjatë periudhës Maj – Qershor 2018
- Ëorkshop mbi prezantimin e mënyrës së plotësimit të PKIE-së
- Trajnim mbi ndryshimet në legjislacionin e prokurimit publik
- Trajnim për Konfliktin e interesit

Për **Produktin I** ”Zgjidhje e konflikteve me të tretët dhe shmangie e detyrimeve të prapambetura”, gjatë 8 mujort të vitit 2018 janë krijuar detyrime kryesisht si rezultat i vendimeve gjyqësore të formës së prerë mbi të cilat Ministria e Kulturës është duke finalizuar përpilimin e databazave përmbledhës për vendimet gjyqësore të formës së prerë për sistemin e kulturës dhe paralelisht po shqyrton mundësinë e ndonjë rialokimi për fonde që mund të rezultojnë të papërdorura përpara mbylljes së vitit buxhetor me qëllim shlyerjen e vendimeve gjyqësore duke respektuar rradhën e paraqitjes së tyre në zbatim të Udhëzimit nr.1 datë 04.06.2018 “Për

mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Nga praktika e vitit 2017, Ministria Kulturës ka treguar se ka mirëadministruar fondet e akorduara në ligjin vjetor të buxhetit 2017, në drejtim të realizimit të këtij objekti me qëllim shmangien e detyrimeve të prapambetura, duke likuiduar 96% nga vlera totale e detyrimeve si rezultat të vendimeve gjyqësore të paraqitura deri në atë vit , prandaj edhe pritshmëritë për sa i përket këtij viti janë të larta.

Në lidhje me **Produktin J** “Zbatim të legjislacionit në fuqi për aparatet e MK dhe institucionet e varësisë”, Sektori i Auditit të Brëndshëm ka zhvilluar veprimtarinë audituese bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet në fuqi si dhe në praktikën më të mira të fushës, me qëllim garantimin e një efience sa më të lartë. Ministria e Kulturës ka realizuar dy misione auditimi me bazë sistemi të kombinuara përkatësisht:

- a. Për Drejtorinë Rajonale të Kultures Korçë.
- b. Për Galerinë Kombëtare të Arteve.

Ndërsa për **Produktin K** “Marrëveshje bilaterale të nënshkruara dhe aplikime për thithje fondesh në programet komunitare”, Ministria Kulturës në lidhje me marrëveshjet ka nënshkruar tre të tilla konkretisht:

1.Marrëveshje bashkëpunimi me Rajonin e Pulias për konkretizimin e projektit “Shoke dhe engjej-Drejt Oficinave të Kulturës”, në kuader të financimit të Parkut të Artit **nënshkruar me datë 06.03.2018.**

2.Protokolli I bashkëpunimit bazuar në “Deklaratën e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritetin strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës”, e datës 11 janar 2014, lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, **nënshkruar me datë 18.06.2018.**

3.Program bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Malit të Zi për periudhën 2018-2020, **nënshkruar me datë 03.07.2018.**

Ndërsa për sa i përket aplikimeve për thithje fondesh në programet komunitare, Ministria e Kulturës ka realizuar një aplikim madhor për të cilin po punohet për të shkruar Application package, atë të IPA me Tematikë Shqipëri-Mali I Zi- Itali: **“Parku I Artit”** si dhe në katër projekte në kuader të programit ADRION, në cilësinë e partnerit.

ADRION është një program transnacional që ka për qëllim të promovojë bashkëpunimin në fushën e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore në tetë shtetet pjesëmarrëse: Shqipëri, Bosnje Hercegovinë, Mali I Zi, Kroaci, Greqi, Itali, Serbi dhe Slloveni.

Aplikimet synojnë krijimin e rrjeteve të përbashkëta me struktura të caktuara në këto shtete për fuqizimin e teatrove, Trashëgimisë Kulturore, restaurimit të monumenteve dhe bashkëpunimin në fushën e dixhitalizimit të muzeve. Ministria e Kultures është duke pritur shqyrtimin e aplikimeve nga Komiteti Organizativ I Programit dhe listën e aplikimeve të suksesshme. Nëse një nga katër aplikimet rezulton i suksesshëm dhe përzgjidhet fituesi, pritet të fillojë implementimi I tij gjatë vitit 2019.

2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 8-mujori 2018		Realizimi 8-mujori 2018			Realizim i në (%) ndaj Buxhetit vjetor sipas Planit të Rishikuar
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj Planit 8-mujorit	
12	08220	600-601	Paga, Sig. Shoq	197,173	56.2 %	190,405	66.4 %	96.6 %	64.4 %
12	08220	602-606	Shpen. Korrente	103,138	29.4 %	84,562	29.5 %	82 %	54.8 %
12	08220	230-231	Shpenz. Kapitale	50,417	14.4 %	11,830	4.1 %	23.5 %	6.1 %
			TOTALI	350,727	100%	286,797	100%	81.8%	44.6 %

Nga të dhënat konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 81.8 % ndaj planit të 8-mujorit 2018 dhe 44.6 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 56.2 % të totalit dhe janë realizuar në 96.6 % ndaj planit të 8-mujorit 2018 dhe 64.4 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar. Shpenzimet korrente zënë rreth 29.4 % të totalit dhe janë realizuar në masën 82 % ndaj planit të 8-mujorit 2018 dhe 54.8 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 14.4 % të totalit dhe janë realizuar në 23.5 % ndaj planit të 8-mujorit 2018 dhe 6.1 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në katër produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Kodi i Programit	08220	Emërtimi i programit	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete							Komente
Qëllimi 1	Ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë materiale (monumente të kulturës, ansambleve arkitektonike, qyteteve muze, qendra historike, zonave dhe parqeve arkeologjike) - rritjen e aksesit të publikut në to në funksion të turizmit kulturor									
	**Treguesit e performancës/Produktet:									
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit të Performancës/Produktit	Emërtimi i Treguesit të Performancës***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar në vitin korent	Niveli i rishikuar në vitin korent	Niveli i planifikuar për periudhën progresive	Niveli faktik në fund të vitit korent	% e Realizimit të Treguesit të Performancës/Produktit	
Objektivi 1.1	Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit									
		F	Objekte të restauruara dhe të mirëmbajtura	276,711	409,152	372,938	200,627	147,436	73%	punimet janë në proces
Objektivi 1.2	Përmirësimi i standardeve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara në muzete dhe objektet e vizitueshëm të Trashëgimisë Kulturore / parqeve arkeologjike									
		G	Muze parqe të mirëmbajtura	160,944	158,861	231,912	125,000	114,171	91%	punimet janë në proces
Objektivi 1.3	Inventarizimi i 5000 objekteve dhe/ose elementeve të trashëgimisë jonmateriale dhe pajisja me kartele teknike									
		I	Objekte të inventarizuara	9,665	10,425	9,912	6,500	6,508	100%	
Qëllimi 2	Ruajtja e trashëgimisë jonmateriale, rivitalizimi e gjuhës dhe zëvillimi i diversitetit kulturor									
	**Treguesit e performancës/Produktet:									
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit të Performancës/Produktit	Emërtimi i Treguesit të Performancës***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar në vitin korent	Niveli i rishikuar në vitin korent	Niveli i planifikuar për periudhën progresive	Niveli faktik në fund të vitit korent	% e Realizimit të Treguesit të Performancës/Produktit	
Objektivi 2.1	Promovimi i sërave të trashëgimisë shpirtërore, materiale dhe diversitetit kulturor përmes zhvillimit të 70 veprimtarive të përvishme.									
		H	Aktivitete, veprimtari kulturore	46,964	56,634	28,445	18,600	18,682	100%	

Programi Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë është një nga programet e Ministrisë së Kulturës i cili synon ruajtjen e integruar të tërësisë së vlerave të trashëgimisë kulturore, mbrojtjen dhe promovimin e saj si dëshmi e vlerave të trashëguara nga e kaluara, si shprehje e identitetit kombëtar dhe si pasuri e traditës kolektive.

Trashëgimia kulturore përbëhet nga vlera materiale të luajtmshme dhe të paluajtmshme (dëshmi të arkitekturës, peizazhit, arkeologjisë) dhe vlera jomateriale që përbëjnë dijen dhe përvojën shpirtërore (ritet, zakonet, zejet tradicionale, folklori dhe gjuha) të krijuar dhe transmetuar nga populli përgjatë shekujve.

Ky program zbatohet nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, pjesë e Ministrisë së Kulturës si dhe nëpërmjet 20 institucioneve në varësi të saj (si Instituti i Monumenteve të Kulturës, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Muzetë Kombëtarë, QKVF, QKIPK, DRKK, Parqet Arkeologjike, etj.) në mbrojtjen, promovimin, edukimin dhe menaxhimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e rrjetit të muzeve kombëtarë dhe lokalë, parqeve arkeologjike dhe lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit efikas dhe efektiv të burimeve financiare shtetërore, maksimizimit të tyre dhe bashkëpunimeve me organet e qeverisjes vendore, partnerë ndërkombëtarë dhe PPP si dhe rritjen e aksesit të publikut në to në funksion të turizmit kulturor.

Sipas objektivave të politikës dhe produktet përkatëse, ju informojmë si më poshtë:

➤ **Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit**

Objekte të restauruara dhe të mirëmbajtura

- Fondet janë rialokuar gjatë vitit 2018, nuk ishin të parashikuara në PBA 2018-2020.

Në vitin 2018 planifikimi i fondeve për investime në Programin “Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë” është **193,000** mijë lekë, do të kryhet restaurimi i 10 objekteve monument kulture si dhe hartimi i projektit për Restaurimin dhe Rifolmulimin e linjës muzeore në Muzeun Historik Kombëtar –Tiranë, projekti i Restaurimit dhe rehabilitimit i hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve, si dhe blerje pajisjesh kompjuterike për të plotësuar me të gjithë aksesorët e nevojshëm biletaritë në disa muze apo monumente kulture të vizitueshëm me biletë. Detajimi i fondeve është sipas tabelës së mëposhtme:

mijë Lekë

Emertimi i projektit	Plani	Realizimi
Muzealizimi Muzeut Gjethi	5,100	4,501
TVSH - Rehabilitimi i Manastirit të shën Mërisë për përdorim muzeal dhe rrethinat e sitit arkeologjik të Apolonisë	6,540	5,845
Blerje Pajisje, Aparati MK	1,354	
Blerje Pajisje Kompjuterike, Aparati MK	960	

Projekti i Restaurimit dhe Rifolmulimi i linjës muzeore në Muzeun Historik Kombëtar-Tiranë	35,000	
Projekti i Restaurimit dhe rehabilitimit i hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve	13,000	
Restaurim “Banesa Vëllezërve Frashëri”	6,000	
Restaurim “Muzeu i Sinjës” - Dibër	1,500	1,484
Restaurimi i Kishës së Ristozit Mborje Korçë, faza III	4,000	
Restaurimi Kisha Shën Mërisë Pëshkëpi e Sipërme-Gjirokastrë	24,600	
Restaurimi me objekt Kisha e Shen Apostujve ,Hoshteve-Zagori	19,200	
Restaurim i Kishës së Shën Nikollit (vend varrimi iSkënderbeut) - Lezhë	33,300	
Restaurim me objekt Kisha e Shën Thanasit-Leshnicë-Sarandë	10,120	
Restaurim Kisha Manastirit të Shën Merise Mesopotam Faza I -Sarandë	24,120	
Restaurim me objekt Ura e Kollorcës, 4 km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat	5,000	
Restaurim Ura Nivanit, Nivan-Ndëran, Zagori, Gjirokastrë	2,360	
Blerje pajisje, Muzeu Kombetar i artit Mesjetar Korçe,	239	
Blerje pajisje, Muzeu Kombetar i Pavarsise Vlore	111	
Blerje pajisje,Muzeu Kombetar i Pergjimeve "Gjethi"	111	
Blerje pajisje, DRKK Durres	222	
Blerje pajisje, Qendra Muzeumeve Berat	17	
Blerje pajisje, DRKK Gjirokaster	17	
Blerje pajisje, Parku Kombetar Apolloni	17	
Blerje pajisje, DRKK Vlore	111	
	193,000	11,830

Gjatë 8 mujorit të vitit 2018 ka përfunduar likuidimi i projektit për ngritjen e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me Gjethë” si dhe pagesa e TVSH - Rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë për përdorim muzeal dhe rrethinat e sitit arkeologjik të Apolonisë Fier financuar nga BE në kuadër të programit IPA multibeneficiary.

Ka përfunduar **Restaurimi i Banesës së Vëllezërve Frashëri** dhe **Restaurimi i Muzeut të Sinjës – Dibër**. Restaurimi i këtyre dy objekteve bëri të mundur shmangjen e degradimit të mëtejshëm të tyre, kthimin e vlerave për trashëgiminë tonë kulturore si dhe futjen e këtyre objekteve në itineraret turistike të zonës por dhe më gjerë.

Ka përfunduar procedura e tenderimit për fazën e hartimit të projektit për **projektin “Restaurimin dhe Riformulimi i linjës muzeore të Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë”**, si dhe është në fazën e tenderimit hartimi i projektit për **Restaurimin dhe Rehabilitimin e hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve**.

Gjithashtu vazhdon puna për restaurimin e 8 objekteve, në 6 kisha dhe 2 ura, monumente kulture të kategorisë së I-rë. Restaurimi i këtyre objekteve do të krijojë mundësinë e ruajtjes së tyre nga degradimi i mëtejshëm, ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore, kthimin e këtyre objekteve komunitetit si dhe shtimin e itinerareve turistike me këto objekte me vlera të trashëgimisë sonë.

Ecuria e realizimit të punimeve në këto objekte është si më poshtë:

Restaurim Kisha e Shën Mërisë në Ristoz, Korçë, Faza e III-të, vazhdon restaurimi i kishës, i cili ka filluar në vitin 2014 - 2015. Restaurimi bëri të mundur heqjen e një monumenti mjaft të rëndësishëm nga lista e riskut të lartë. Aktualisht kanë filluar ndërhyrjet restauruese dhe konsoliduese në kupolën e kishës, punimet janë realizuar në masën 15 %.

Restaurim Kisha e Shën Mërisë Peshkëpi e Sipërme - Gjirokastrë, me fondin 24,600,000 lekë, do të kryhen ndërhyrje restauruese në mure, kupolë, çati, restaurim dhe konservim i pikturave, si dhe restaurim i të gjithë elementeve arkitektonikë në brendësi të Kishës. Punimet faktike 30%, deri tani janë realizuar studimi gjeologjik, sondazhet në themele, çmontimi i rrasave të gurit në çati, lehtësimi i strukturës nga mbushjet e bëra në ndërhyrjet në vite, qepja e kupolave dhe qemereve, etj.

Restaurim Kisha e “Shën Apostujve” Hoshtevë, Zagori, me fondin 9,199,330 lekë, do të kryhen ndërhyrje restauruese të muraturës së narteksit, këmbanarja, si dhe ndërhyrje në çati, në fugatime të muraturës, në pikturën murale, dekoracionin prej druri, si dhe sistemime të sheshit përreth (drenazhim dhe plotësim i murit të rrethimit). Krahina e Zagorisë, ku ndodhet fshati i Hoshtevës, shquhet për bukuritë e rralla natyrore dhe trashëgiminë kulturore të saj. Vlerësimi dhe mirëmbajtja e kësaj trashëgimie, ndihmon në rritjen e vlerave dhe njohjen më tej të kulturës së kësaj zone. Në këtë këndvështrim, restaurimi i Kishës së Hoshtevës, do të ndihmojë në njohjen e kulturës dhe traditës së ndërtimitarisë së zonës dhe të periudhës të cilës ajo i përket. Bazilika e shekullit të 19-të e “Apostujve Pjetri dhe Pali”, vlerësohet për nga trajtimi arkitektonik i saj dhe për këmbanaren e veçantë oktagonale. Restaurimi i saj, do ta risjellë në vëmendje këtë monument si për vizitorët e krahinës ashtu edhe për studiuesit.

Restaurim i kishës së Shën Nikollit (Vend varrimi Skënderbeut) – Lezhë, projekti i restaurimit parashikon ndërhyrje thelbësore dhe të domosdoshme për ti dhënë objektit rëndësinë dhe paraqitjen dinjitoze për atë çka përfaqëson, do të rikthejë me një formë e përmbajtje të re jo vetëm qytetit të Lezhës por gjithë shqiptarëve një monument të dashur kulture që i ka bërë krenarë me historinë e tij. Restaurimi i këtij monumenti, përbën interes të veçantë historik, arkeologjik e kulturor. Punime faktike 60 %. Pas mbarimit të montimit në pjesën e mbulesës, punimet janë fokusuar kryesisht në Kishën e Shën Nikollit.

Restaurim "Kisha e Shën Thanasit"- Leshnicë-Sarandë. Ndërhyrjet konsistojnë në konservimin dhe konsolidimin e pjesës së mbetur të Kishës pas tërmetit në vitin 2017. Do të kryhet pajantimi i gjithë qemereve dhe kupolave para nisjes së punimeve, konservimi e konsolidimi i pikturës murale, ringritja e murit jugor të naosit, ringritja e tre kolonave të naosit me materialin origjinal të ndodhur në vend, çmontimi i çatisë së nartekstit e ndërtimi i një çatie të re, çmontimi i paretit të brendshëm në disa zona në nartekst dhe rindërtimi i tyre, përforcimi i strukturës nëpër qoshe, vendosja e një tavani dërrase, restaurimi i dyerve të drurit etj, punime faktike 20 %.

Restaurim Kisha Manastirit të Shën Mërisë Mesopotam Faza I -Sarandë, do të mundësohet ruajtja dhe konsolidimi i skemës egzistuese statike, funksionale dhe tipologjike të këtij objekti me vlera për trashëgiminë tonë kulturore dhe arkitektonike. Punimet kanë filluar me ndërtimin e një mbulese të përkohshme, për mbrojtjen nga lagështia për gjithë strukturën e kishës, puntelimin e qemereve dhe harqeve të kupolave për të siguruar qëndrueshmërinë e objektit gjatë punimeve. Do të kryen fugatime, injektime, riplotësime të elementëve konstruktivë të shoqëruara me qepje të çarjeve, integrimin e pjesëve të reja të muraturës me të vjetrat si dhe restaurimin e çatisë. Struktura përforcohet me tiranta inoksi, plotësim kollonash nën harkadë duke e rikthyer në gjendjen e mëparshme. Injektimi i muraturës, dhe fugatimi i saj. Të gjitha punimet do të realizohen sipas specifikimeve teknike të dhëna, punime faktike rreth 50 %.

Restaurimi i Objektivit Ura e Kollorcës 4 km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat 4,980,000 lekë, Me anë të kësaj ndërhyrje, sigurohet qëndrueshmëria e urës dhe jep mundësinë e restaurimit të plotë të saj në të ardhmen. Është miratuar vetëm faza e shpëtimit, faza emergjente. Ndërhyrjet konsistojnë në përforcimin e dy prej këmbëve të urës. Përforcimi është menduar si fazë emergjente për arsye të humbjes së materialit nën tabanin e themelit të njëres prej këmbëve kryesore si pasojë e përbërjes prej zhavorri. Këmbët janë menduar të përforcohen me beton të armuar, të rrethuar me gabionë me gurë dhe rrjeta inoksi, aty ku materiali i mbështetjes është zhavorr. Punime faktike: 60 %.

Restaurim Ura Nivanit, Nivan-Ndëran, Zagori, Gjirokastrë, punime faktike 20 %. Punimet janë në fazën e tyre fillestare. Është bërë pastrimi i nga bimësia, i parashikuar në projekt dhe po zbatohet fugatimi.

Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit, monumentet e kulturës të mirëmbajtura dhe inspektuara në mënyrë të vazhdueshme.

Në përbushje të një prej objektivave të Ministrisë së Kulturës “Të ruajë, mbrojtë dhe promovojë trashëgiminë kulturore”, Drejtoria e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, i kushton vëmendje të veçantë rehabilitimit të Monumenteve të Kulturës për t’i shndërruar ato dhe në produkte turistike kulturore, nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare, Parqeve Kombëtarë Arkeologjike si dhe me mbështetjen e IMK dhe ASHA.

Në vazhdim të eksperiencës në menaxhimin e fondeve për mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës, nga fondet art. 602 që institucionet kanë në dispozicion janë marrë masat për përdorimin me efektivitet të këtyre fondeve me synim mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës nëpërmjet konservimit, konsolidimit, restaurimit të tyre. **Theksojmë se këto fonde janë të pamjaftueshme për të kryer mirëmbajtjen e monumenteve dhe në të shumtën e rasteve përdoren për të nxjerrë objektet nga rreziku i shëmbjes.**

Gjatë 8 mujorit të vitit 2018 janë kryer punime mirëmbajtjeje, konsolidimi, në rreth 115 objekte dhe pastrim vegjetacioni në 70 objekte monument kulture nga DRKK Durrës, Berat, Shkodër, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë. Këto institucione përgatisin objektet e trashëgimisë kulturore për sezonin turistik si dhe vazhdojnë mirëmbajtjen e tyre rutinë si dhe mbrojtjen nga dëmtimet dhe degradimi nga agentët atmosferikë. Gjithashtu dhe Parqet Arkeologjike kryejnë punime mirëmbajtje të përqendruara në përmirësimin e performancës së institucioneve të trashëgimisë si edhe në ndërhyrje restauruese dhe mirëmbajtje në monumentet e kulturës.

Sipas Institucioneve janë kryer punime mirëmbajtje nga:

DRKK Durrës me specialistët dhe punëtorët e institucionit ka kryer punime rutinë mirëmbajtje dhe pastrime nga vegjetacioni dhe mbeturinat, në rreth 23 objekte monument kulture. Janë kryer

pastrime dhe mirëmbajtje në Bazilika Arapaj, në Muzeun Arkeologjik Durrës, në Amfiteatër, në Hamamin Mesjetar Durrës, në Banesën Aleksander Moisiu, Muret Rrethuese, Termat Romake, Macellum Forum (Rotonda), Kalaja e Skënderbeut dhe Kisha e Shën Ndout në Kepin e Rodonit, në Rrenojat me mozaik GORA, etj. Pastrime dhe mirembajtje në kalanë e Prezës, në Murin e Portës, Pusin e Top Hanes, në Mozaikun e Tiranës, në Urën e Tabakëve etj. Punime mirëmbajtje kalaja e Elbasanit, kalanë e Ishmit, çezma dhe kalldrëmi në Rrapin e Bezistanit, kalaja Krujë,

DRKK Berat, me specialistët dhe punëtorët e institucionit dhe në disa objekte edhe në bashkëpunim me pronarët ka kryer ndërhyrje restauruese, mirëmbajtëse, konsolidime, pastrime nga vegjetacioni i ulët dhe i lartë, në 41 objekte monument kulture kështu: pastrim nga vegjetacioni në disa kisha në lagjen Kala, restaurim i dy ikonave, trajtimi i portave të kishave monument kulture në lagjen Kala, pastrim nga bimësia në Qendrën Historike të qytetit të Beratit, pastrim teritori të kishës Shën Vllahernës, të kishës të Shën Kollit, të kishës së Shën Triadhës. punime mirëmbajtje në zyrat e DRKK Berat, ndërhyrje emergjente në mure mbajtëse në lagjen Mangalem, Restaurimi i kalldrëmit në lagjen Goricë, pastrim nga vegjetacioni në lagjen Mangalem, Goricë dhe Kala. Restaurim dhe mirëmbajtje në çatitë dhe fasadat e 12 banesave monument kulture, etj.

DRKK Gjirokastër, me specialistët dhe punëtorët e institucionit ka kryer mirëmbajtje, pastrime, sistemime në Kalanë Gjirokastër, ndërhyrje restauruese në 38 objekte si në: banesën Zeko, banesa Çabej, Ndërhyrje në portën Sinoimeri, Kore e Stavri. Ndërhyrje restauruese e përforcuese në banesën Fico, Konomi, Duka, Sinoimeri, Koko, S.Karauli, Xhelili, Qendro, etj. Punime mirëmbajtje kisha Shën e Premte në Përmet, ndërhyrje restauruese në kishën e Shën Mërisë në fshatin Vraho Goranxi, ndërhyrje emergjente kroi i Selckës, ndërhyrje restauruese në portat hyrëse të kalave Gjirokastër , Libohovë, mirëmbajtje, pastrime, sistemime në Parkun Antigone dhe Adrianopol. Inspektim dhe pastrim nga vegjetacioni në rreth 16 objekte si: kisha e Shën Mëhillit dhe kisha e Shën Thanasit në fshatin Lekël, Teqeja e Koshtanit, kalaja e Qytezës në fshatin Dukaj, në kalanë e Tepelenës, kalaja e Kalivaçit, kalaja e Zharres, kalaja e Nivicës, Mulliri i Nivicës, Akuadukti i Bënçës, urën metalike të Dragotit, ura Antiko – Mesjetare mbi lumin Vjosë në kalanë e Tepelenës, pastrim në rrenojat e urës së Muço Hysës, etj.

DRKK Vlorë, me specialistët dhe punëtorët e institucionit ka kryer mirëmbajtje në 19 objekte, si në punime mirëmbajtje kisha e Panaisë, kisha e Ipapandisë, Vendosija e biletarisë në kalanë e Kaninës, punime mirëmbajtëse Muzeu Etnografik, Muzeu Historik, Muri rrethues i kalasë së Onhezmit, Ura e Çinës mes Tatzatit e Kalasës, Vendosija e derës në Muzeun e P.A.Amantia si dhe pastrimi i kanaleve të drenimit në P A Amantia.

Inspektim dhe pastrim vegjetacioni në rreth 30 objekte, si në: Manastiri i 40 shenjtorëve, Bazilika – Sinagogë Sarandë, Tempulli antik Çukë, Tempulli Antik Metoq, kisha e Shën Kollit Armen, Manastiri ishin Gjergjit, Leshnicë e Sipërme, Manastiri i Shën Thanasit, Leshnicë e Sipërme, Kullat e Manastirit të Theollogos, Manastiri i Shën Triadhës, Manastiri i Shën Thanasit Pecë, Manastiri Shën Kollit Mesopotam, Bazilika e Peshkopisë, Manastiri i Zvernecit, Kisha e Sergjit dhe Bakut, Kisha e Shën Stefanit Manastiri i Shën Mërisë Kakome Kalaja e Mavrovës Kalaja e Kaninës, Kalaja e Porto Palermos, Kalaja e Lëkursit, Kalaja e Himarës, etj.

DRKK Shkodër, u kryen punime mirëmbajtje dhe pastrimi periodik nga punëtorët e mirëmbajtjes në monumentin Kalaja e Shkodrës janë kryer punime restauruese dhe konsoliduse, Mirembajtje, pastrim vegjetacioni Kisha e Shërgjit, Kalaja e Lezhës, Kalaja e Grazhdanit, Ura e Mesit, etj.

DRKK Korçë, Punime sistemimi e mirëmbajtje në Kishat në Voskopojë (Kisha e Shën Kollit, Manastiri i Shën Prodhomit, Kisha e Shën Marias, Kisha e Shën Ilias.) Punime mirembajtje në

Kishat në Vithkuq (Kisha Shën Kozmai dhe Damian, Manastiri i Shën Pjetrit, Kisha e Shën Mehillit). Punime në pikturën murale në kishën e Shën Gjergjit Shpëskë, në kishën e Shën Nikollës Voskopoje, në kishën e Shën Thanasit Voskopoje, në Manastirin e Shën Prodhomit Voskopoje si dhe në pikturën murale në Manastirin e Shën Dhimitri Boboshticë.

Punime mirembajtje në banesën e Sandri Qipros, Pogradec, mirembajtje në Muzeu i Arsimit ABC, në fasadën e Muzeu Arkeologjik, mirembajtje në Tuma e Kamenices, Varret Monumentale të Selcës, Pogradec, sistemime të territorit dhe pastrim nga bimësia Ura e Shën Prodhomit, etj.

➤ **Përmirësimi i standarteve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara në muzete dhe objektet e vizitueshëm të Trashëgimisë Kulturore / parqeve arkeologjik.**

Muze parqe të mirëmbajtura

Aktiviteti kryesor i Muzeve Kombëtarë është promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore si dhe edukimi përmes trashëgimise dhe aktiviteteve në funksion të saj. Një komponent i rëndësishëm është dhe pasurimi me fonde dhe përmirësimi i prezantimit përmes ekspozitorëve dhe përshkrimeve të objekteve në nivele bashkëkohore. Njëkohësisht pjesë e veprimtarisë së këtyre institucioneve janë edhe realizimet e veprimtarive dytësore si filmimet, fotografimet e objekteve muzeore nga subjekte të treta, si dhe riprodhimi i imazhit të objekteve të trashëgimisë kulturore, me qëllim ekspozimin e tyre, në kuadër të aktiviteteve të ndryshme.

Muzeu Kombëtar të Fotografisë “Marubi”, përveç performancës lidhur me vizitueshmerinë ka realizuar dhe aktivitete të tjera promovuese me qëllim publikimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si edhe në kuadër të Programit Edukimit mbi dhe përmes Kulturës, aktivitete me karakter edukues në bashkëpunim me shkollat e qytetit.

Janë organizuar ekspozita e konferenca, si ekspozita “Urtësi sot e mot”, ekspozita e fotografit Angjelin Nënshati, “Dëshmitar midis dy kohëve”, ekspozita e autores italiane Moira Ricci , “Lookaftering”, ekspozita Punëtorja “Made in Marubi”, Publikimi i librit “Ekspozitat e Marubi, konferenca “Arti Bashkëkohor dhe Trashëgimia Fotografike”. Një bashkëpunim mes Art House Muzeut Marubi, sollti për herë të parë në gjuhën shqipe përkthimin e njërit prej teksteve më të rëndësishëm për historinë e fotografisë, “Dhoma e Dritshme” e autorit Roland Barthes, përkthyer në shqip nga Zef Paci. Libri do të prezantohet në festivalin e filmit “Ekрани i Artit”.

Muzeu Historik Kombëtar, Gjatë 8 mujorit 2018, ka realizuar një sërë veprimtarish me karakter promovues, edukues në të gjithë pavionet e këtij muzeu si dhe restaurimi i një sërë objektesh të trashëgimisë kulturore pjesë e fondit të muzeut, ndërhyrjet konservuese të disa objekteve për mirëmbajtjen e tyre si dhe përfundimi i katalogut “Thesare nga Muzeu Historik Kombëtar”.

Aktivitete në nderim dhe përkujtim të figurave patriotike shqiptare si dhe në kuadër të programit “Edukimi mbi dhe përmes kulturës” u zhvilluan projektet edukative “Arkeologu i vogël”, Një pasdite në muze”, “Vizatorj historinë”, “Muzeu im” “Një orë leksioni në muze”, “Traditë dhe shije”, aktivitet me nxënësit e shkollës “Musine Kokalari, duke ndërthurur elementë art, kulturë dhe gatime tradicionale nga treva të ndryshme. Në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut janë kryer një sërë vizitash dhe aktivitete nga nxënësit e shkollave 9-vjecare të qytetit, si dhe ekspozita lidhur me figurën e Heroit Kombëtar dhe epokës së lavdishme

të tij, si Ekspozita “Moti i Madh”, 17 janar 2018, jeta dhe veprimtaria e Gjergj Kastriot Skënderbeut, Ekspozita me temë “Monarkia Austro-Hungareze dhe Shqipëria 1916-1918” (Viti kulturor Austri-Shqipëri 2018, Ekspozita “Skënderbeu” me autor Gjovalin Paci, Ekspozita personale me titull: "Midis ëndrrës dhe realitetit" me autore Eliza Hoxha, Ekspozita “Jehona përmes shekujve- Gjergj Kastriot Skënderbeu”, 8 maj 2018, me koleksionin e 37 librave të koleksionistes Patricia Nugee etj aktivitete në 18 maj, Dita Ndërkombëtare e Muzeve, Pjesëmarrje në panairin “Ditënetët e librit”, me libra për figurën e Heroit Kombëtar, 16-20 maj 2018, Ekspozita “Besëlidhja e lirisë 1878” në kuadër të 140 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Janë promovuar publikime të ndryshme si: promovimi i librit “Lufta e Kosovës”, “Ëngjëjt e errësirës”, Korpusi i mozaikëve”, “ Skënderbeu në vendet nordike”.etj. MHK kemi realizuar 2 botime, (në dorëshkrim) që janë fryt i një pune sistematike kërkimore, Hyrje në Muzeologji dhe Përmbajtja e Muzeut Historik, korrik 2018.

Në kuadër të kalendarit të përbashkët kulturor vjetor ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Muzeu Historik Kombëtar në bashkëpunim me Muzeun e Kosovës çelën në Prishtinë ekspozitën “ Unë jam Shqiptar” 10 gusht 2018. Çelja e ekspozitës me titull “Shpirti arbëresh në veshje, 31 gusht 2018.

Muzeut Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë.

Veprimtaria e këtij institucioni është përqëndruar në pritjen e vizitorëve dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë ikonografike, që administrojnë ky muze. Gjithashtu dhe në aktivitete promovuese dhe edukuese në kuadër Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut dhe programit Edukimi mbi dhe përmes Kulturës. Në bashkëpunim me shkollat 9 vjecare, të mesme dhe universitetin, janë zhvilluar aktivitetet: “Skënderbeu në mite, gojëdhëna e tregime”, “Dashuria për natyrën”, “Kultura antike e vonë”, “Arti I shek.XVIII: Atelieja e Athanas dhe Kostandin Zografit”, "Arkeologjia eksperimentale", etj. **Muzeu i Arsimit, Korçë**, në ambientet e tij janë zhvilluar aktivitete në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme historiko-kulturore të krahinës së Korçës dhe të Shqipërisë, ku janë ekspozuar fotografi, dokumenta, objekte të ndryshme, dhe janë shfaqur dokumentarë.

Gjatë kësaj periudhe nga specialistët e muzeut janë trajtuar objekte të ndryshme për pastrimin dhe konsolidimin e tyre, për t'i kthyer në gjendje të qëndrueshme dhe të ekspozueshme.

Qendra Kombëtare e Muzeumeve Berat,

Për mbarëvajtjen e procesit të punës dhe mirëmbajtjen e objekteve janë kryer kartelizimi dhe inventarizimi i objekteve të shërbesës me material druri, të inkuorpuara brenda sallës qendrore të Katedrales “Fjetja e Shën Mërisë”. Dezinsektimi i ambienteve dhe objekteve. Konsolidimi dhe konservimi i disa objekteve për mirëmbajtjen e tyre. Përgatitja e kartelave të reja për disa nga objektet e shtuara në koleksionin e Muzeut Etnografik gjatë vitit 2018, të dhuruara nga DRKK Berat, objekte në metal të grumbulluara gjatë ndërhyrjeve restauruese në vite të banesave në lagjet muzeale të Beratit. Përgatitje dhe përditësim informacioni, fletëpalosje në kuadër të fillimit të sezonit turistik.

Janë realizuar një sërë aktivitete me karakter promovues, edukues mbi vlerat e trashëgimisë kulturore, pjesë e fondit të QKM-Berat. Projekti “*Artizanati dhe Brezi i Ri*”- Prezantimi, njohja e nxënësve me artizanatin Beratas, ekspozita “Arti i drugëdhëndjes të ushtruar nga një mjeshtër beratas”, së bashku me ekspozitën “*Muzeu në valixhe*”.

Në kuadër të 18 Prillit “*Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve, Ditës Botërore të Trashëgimisë Kulturore*” dhe vitit të kultures Shqiperi-Austri, QKMB-ja prezantoi në pedonalen e qytetit të

Beratit ekspozitën “Pazaret mesjetare të Beratit”, një cikël me 15 foto të vjetra të Qytetit të Beratit të viteve 1908 – 1940 të mbledhura nga Arkivat Austro – Hungareze. Organizimi i Ëorkshop-it me nxënësit, “Inventarizimi dhe digjitalizimi i trashëgimisë kulturore”. Ekspozita “Muzeu Lëvizës” Në kuadër të programit “Edukimi përmes kulturës”, u hap ekspozita me 13 objekte nga koleksioni i Muzeut Etnografik, në Qendrën e Fëmijëve Autik “Shën Asti”, Berat. 18 Maj “Ditës Ndërkombëtare të Muzeve”, Ekspozitë me 25 panela me imazhe të mjediseve dhe koleksionit të Muzeut Ikonografik ‘Onufri’. Njëkohësisht u zhvillua një guidë historike mbi vlerat e këtij institucioni muzeor. U shpërndanë për të pranishmit materiale promocionale nga Muzetë e QKM Berat, si dhe u dhuruan bibliotekës së I E V P Berat një seri librash të grumbulluara nga specialistët e QKMB-së.

Muzetë Kombëtarë “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe Etnografik, Krujë. Fokusi kryesor i punës në të dy muzetë ka qënë ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i vlerave muzeore, si dhe mirëmbajtja e tyre. Gjatë periudhës janar- gusht ndër prioritet kryesore ka qënë vizitueshmëria si dhe aktivitete me karakter promovues dhe edukues, në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut dhe Programit Edukimi mbi dhe përmes Kulturës. Në bashkëpunim me bashkinë Krujë dhe shkollat 9-vjecare të qytetit të Krujës dhe qyteteve të tjera, janë zhvilluar aktivitetet si “550 vjetori I vdekjes së Skënderbeut” *Veprimtari letraro-artistike kushtuar 550- vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu*. Ekspozita “Gjergj Kastrioti Skënderbeu përmes monedhës dhe pullës shqiptare”. Mësoj dhe Argëtohem, me Skënderbeun”, organizuar me 26 janar 2018 nga Muzeu “Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Krujë”, me pjesëmarrjen e nxënësve të klasës së tretë ,Shkolla nr.4, Krujë. “Dita Ndërkombëtare e Udhërrëfyesve Turistikë (21 Shkurt), organizuar nga Muzeu “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe Muzeu Etnografik, në bashkëpunim me Shkollën NR.1. Krujë. “Përkujtojmë Kuvendin e Lezhës”. organizuar nga Muzeu “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe Shkolla “Besëlidhja”,Lezhë. Aktivitete si “Trashëgimia Kulturore Për Brezat”, “Në Rrugët e Skënderbeut”, “Muze që komunikojnë me të gjitha format, Qasje të reja, publik i ri, me nxënës të shkollave të rrethit Krujë”.

Muzeu Kombëtar Pavarësia Vlorë ka kryer një sërë aktivitetesh me karakter promovues dhe edukues, si dhe aktivitete në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme historike-kulturore, ekspozita të aristëve të rinj, promovime librash, me fokus kryesor promovimin e trashëgimisë sonë kulturore dhe vlerave muzeale. Aktivitet me rastin e 99-vjetorit të vdekjes së Ismail Qemalit. Në bashkëpunim me Bashkinë dhe Prefekturën u përkujtua kjo ngjarje dhe u mbollën 4 pemë me financimin e Bashkisë Vlorë. Ekspozitë fotografike me pamje të rralla e historike të qytetit të Vlorës në gjysmën e parë të shek 20, etj.

Muzeut Kombëtar “Gjethi” është fokusuar në objektivat kryesore për promovimin e vlerave historiko-kulturore që mbart ky institucion, si dhe pritjen e vizitorëve, me qëllim njohjen dhe ndërjegjësimin e brezit të ri mbi të kaluarën komuniste u zhvillua projekti “Kujtojmë për të mos harruar”, dhe “Mbresa”, ekspozitën "Rruga e Shqipërisë në Komunizëm", si dhe ka marrë pjesë në konferencën me temë "Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethë" në Përballje me të Kaluarën. Ekspozita dhe konferenca u mbajtën në Muzeun Municipiului Palatul Sutu, Bukuresht, e cila do të qëndroi e hapur deri më datë 15 shtator 2018. Pjesëmarrje në konferencës “Meet, see, do” organizuar nga BMN (Balkan museum Netëork), Aktivitet përkujtimor për kompozitorin Lec Kurti. Shtigje rinore, 23 qershor 2018, organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Muzeu Kombëtar "Gjethi" si institucion bashkëpunues. Eventu u promovua nga

sopranoja shqiptare njëkohësisht dhe atashe kulturor i Ambasadës shqiptare në Bukuresht: znj. Arlinda Morava.

Zyra e Administrim dhe Koordinimit të parkut Arkeologjik Apoloni ka ndërmarë disa ndërhyrje emergjente mirëmbajtje të cilat ishin të paevitueshme.

-Ndërhyrja në çatin e portikut të muzeut pas dëmtimit të gjithë pjesës lindore të tij nga stuhia e forte që ndodhi në këtë zonë. Ndërhyrja u realizua nga ana e stafit të ZAKPA Apoloni dhe firmës AD STAR e cila ka realizuar edhe projektin e Manastirit.

-Konsultim me ekspertët e IMK-së për situatën kritike të murit të Temenosit por edhe për murin rrethues të Manastirit. U realizua pastrimi i vegjetacionit të këtyre dy zonave për të bërë një studim më të detajuar për ndërhyrjet restauruese e nevojshme.

-Marrja e ikonës triptike nga ana e grupit të punës të kryesuar nga përgjegjësi I sektorit të Artit në IMK z. Agron ISLAMI për të realizuar ndërhyrjen konservuese të saj në laboratorin e IMK-së.

Kanë vazhduar paralelisht pastrimet periodike nga vegjetacioni në monumentet e parkut arkeologjik. Karakteri i punimeve është i lidhur me mirëmbajtjen e monumenteve dhe ambjenteteve rreth tyre. Është prerë vegjetacioni në sektorin e manastirit dhe në hapësirën jashtë tij duke bërë prerje masive në tarracën perëndimore dhe në sektorin e murit lindor jashtë manastirit. Pastrimi i monumenteve nga vegjetacioni vazhdoj në sektorin e agorasë ku kërkohet pastrim të vazhdueshëm në periudhën e lulëzimit të vegjetacionit. Paralelisht është bërë pastrimi dhe evakuimi i mbeturinave jashtë parkut arkeologjik.

Pastrimi i monumenteve nga vegjetacioni u realizua në gjithë monumentet e agorasë: Bouleterioni, Magazinat, Bibloteka, Stoa A, Stoa B, Muri i Amforave, Muri i Temenosit, Prytaneoni, Tempulli Jonik, Faltore A, Faltore B, Cisterna dhe Magazinat si edhe në territorin përreth monumenteve, gjithashtu dhe në Murin rrethues të anës lindore në sektorin midis dy portave, Banesa me Impluvium, Rruga H dhe kulla e rrumbullaket në hyrje të parkut arkeologjik. Në kuadër të ditëve ndërkombëtare të trashëgimisë me fokus në promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të sitit, në kuadër të programit “Edukimi përmes Trashëgimisë” dhe projekteve të bashkëpunimit ka organizuar 3 aktivitete.

“Ciceroni i Vogël”, dhe trajnimi dy ditor “Cicerion apo Pasqyrë” të zhvilluar në kuadër të nismës së Ministrisë së Kulturës “Edukimi përmes kulturës”.

Aktivitetet janë realizuar me Qendrën Rinore “Epoka e Re” si dhe shkollat publike dhe jopublike të qytetit të Fierit, Janaq Kilica, Flatrat e Dijes, Dertliu, Perikli Ikonomi, Andon Xoxa etj në kuadër të bashkëpunimit me institucionin e DAR-it Fier për 18 prillin, 22 prillin dhe sidomos aktivitetet edukative dhe argëtuese.

Flashmob i realizuar në 22 prill (Dita e Tokës) në moton “ Të mbrojmë natyrën dhe monumentet” në bashkëpunim me Qendrën Rinore “Epoka e Re” dhe “Lulekuqet e Dancit” Fier. Ndezja e Flakës Olimpikë e realizuar nga shkolla “Muco Delo” e cila në bashkëpunim me ZAKPA Apoloni realizuan një nga ceremoni antike.

Zyra e Administrim Koordinimit Butrint

3 aktivitete të organizuara në kuadër të ditëve ndërkombëtare të trashëgimisë me fokus në promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të sitit, në kuadër të programit “Edukimi përmes Trashëgimisë” dhe projekteve të bashkëpunimit

- “Reconnect - Bashkëpunimi rajonal për zhvillimin e qëndrueshëm të ekosistemeve detare”
Organizatorë: Fakulteti i shkencave të natyrës, ZAKB, Prefektura Vlorë, Sipa Tours, Policia e Kufirit, Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Bashkia Konispoli, Bashkia Sarandë, ndërkufitare.

Objektivi i përgjithshëm i projektit RECONNECT: Pasqyrimi i problemeve të përbashkëta të kërcënimeve mjedisore dhe përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve menaxhuese, duke promovuar menaxhimin efikas të burimeve natyrore përmes bashkëpunimit ndërkufitar.

Qëllimi: Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi ndërkombëtar midis ekosistemeve të kërcënuara të Zonave të Mbrojtura Detare (ZMD) dhe zonave “Natura 2000” të Greqisë, Qipros, Bullgarisë dhe Shqipërisë, të cilat do të zbatojnë një strategji të përbashkët të ruajtjes.

- Aktivitetet në kuadër të programit “Edukimi përmes Trashëgimisë” si: “Ju dhe fytyrat nga lashtësia” me pjesëmarrjen nxënës të shkollës 9-vjeçare Mursi dhe Xarrë, të cilët u njohën me artin e portretit në shekuj si dhe zhvilluan një lojë eksperimentale të të kuptuarit të portretit, nëpërmjet portreteve të ekspozuara në Muzeun Arkeologjik Butrint. Kafshët e mozaikut të dyshemesë së Baptisterit me pjesëmarrjen e nxënësve të Shkollës 9-Vjeçare “5 Dëshmorët” Ksamil.


Zyra e Administrim dhe Koordinimit të parkut Arkeologjik Bylis, janë kryer pastrimet periodike nga vegetacioni në monumentet e parkut arkeologjik, punimet kryhen me objektiv mirëmbajtjen e monumenteve dhe ambjenteve rreth tyre. Gjithashtu janë zhvilluar disa aktivitete si: Bisedë e hapur me nxënës të Shkollës së mesme Panahor dhe shkollës së mesme Hekal - Takim dhe bisedë e hapur me nxënësit e shkollave në kuadër dhe të programit "Edukimi përmes kulturës" dhe specialistë të fushës mbi vlerat e mëdha të trashëgimisë kulturore të sitit të Bylist si ndër më të lashtët në rajon.

VIZITUESHMËRIA NË INSTITUCIONE DHE QENDRA TË TRASHËGIMISË KULTURORE JANAR – GUSHT 2018

I. Vizitueshmëria në periudhën Janar – Gusht 2018

Institucionet dhe qendrat e trashëgimisë kulturore gjatë 8- mujorit (janar – gusht) 2018 janë vizituar nga **720,410** vizitorë vendas dhe të huaj, nga të cilët **208,316 në** Muzetë kombëtarë, **283,129** në parqet arkeologjike dhe **228,965** në monumente të kulturës.

Grafiku si më poshtë



Analiza krahasuese e të dhënave statistikore për periudhën Janar - Gusht 2017 dhe 2018 dëshmon se trendi i vizitueshmërisë ka shënuar rritje.


Periudha janar – gusht 2018 shënon 267,273 vizitorë në total më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2017 dhe 336,954 vizitorë në total më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2016.

Trendi i vizitueshmërisë (vizitorë në total) në periudhën janar – gusht në vitet 2014-2018 (në %) Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017, vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej 59%.



Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej 88%.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2015 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej 109%.




Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2014 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej 176%. Grafiku si më poshtë.



Trendi i rritjes progresive vihet re edhe në kategorinë e vizitorëve me biletë dhe të ardhurat e gjeneruara nga institucionet. Grafikët më poshtë.



Trendi i vizitueshmërisë për periudhën janar – gusht 2014 - 2018 sipas kategorive të institucioneve dhe qendrave të vizituara është sipas grafikëve më poshtë:



Rritja e numrit të vizitorëve ka bërë dhe rritjen e të ardhurave nga biletat të cilat mund të përdoren në mirëmbajtjen e Monumenteve të Kulturës, Parqet Arkeologjike dhe Muzete Kombëtarë si dhe për të përballuar detyrimet për ruajtjen e objekteve apo çdo detyrim tjetër që lidhet me to. Nisur nga sa më sipër Ministria e Kulturës kërkon dhe rritjen e limitit të përdorimit të të ardhurave nga institucionet tona.

- **Promovimi i vlerave të trashëgimisë shpirtërore, materiale dhe diversitetit kulturor përmes zhvillimit të 70 veprimtarive të përvitshme.**

Aktivite, veprimtari kulturore

Ministria e Kulturës dhe institucionet e saj të trashëgimisë kulturore kanë organizuar një seri veprimtarish lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të ekspozuara in-situ ose të sjellë pranë publikut apo dhe të ekspozuara në ambientet e Ministrisë së Kulturës.

PROJEKTET E TRASHËGIMISË JOMATERIALE QË JANË ZHVILLUAR NË PERIUDHËN MARS-GUSHT SI DHE PJESËMARRJA NË KËTO AKTIVITETE

Projektet me Thirrje për vitin 2018 të Trashëgimisë Jomateriale: 29 projekte të miratuara, nga të cilat 8 të dedikuara për Programin Kombëtar “Edukimi përmes kulturës”, 7 dedikuar artizanatit dhe kulinarisë, 5 festivale 5 aktivitete multikulturore dhe 4 të ndryshme.

Projektet me Thirrje (Mars-Gusht 2018) (AKTIVITETE) :

1.Realizuar projekti “*Traditë Arti Kulturë*”- *Çelsat e ruajtjes së Trashëgimisë*”, oganizuar nga Shoqata CESVI në qytetin e Përmetit më 14 mars, ku morën pjesë 32 artistë (21 meshkuj 11 femra), artizanë 16 (12 femra 4 meshkuj), nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe Gjimnazi “S.Frashëri” 60 nxënës (35 femra 25 meshkuj), stafi organizator CESVI, anëtarë të Lëvizjes SLOË Përmet, anëtarët e konsorciumit Pro Përmet (artizane, biznese, kuzhinierë 74 persona (43 meshkuj 31 femra). Edukim/shfaqje folklorike/ panair kulinarie. Morën pjesë Gjimnazi Publik “*Sami Frashëri*” dhe Shkolla 9-vjeçare “*Nonda Bulka*”.

2.**Festivali Ndërkombëtar Folklorik “Aulona Inter Folk Festival”**, edicioni i 10-të zhvilluar në qytetin e Vlorës në datat 12,13,14 maj 2018, organizuar nga Qendra Kulturore “Aulona” Vlorë. Morën pjesë 300 artistë, femra 70, fëmijë 10. Gjithsej morën pjesë 10 grupe nga Shqipëria, Kina, Kosova, Greqia, Sllovakia, Letonia, Italia dhe Bullgaria. Shfaqje folklorike/Festival

3.**Festivali i 15-të Mbarëkombëtar i Instrumentistëve të vegjël popullorë**, zhvilluar në qytetin e Fushë Arrëzitet në datat 18,19,20 maj, zhvilluar nga Shoqata Eko-Turistike, Pukë. Morën pjesë 140 artistë të vegjël nga të gjitha trevat shqipfolëse. Shfaqje folklorike/Festival.

4. Projekti “*Java e Ali Pashës*”, zhvilluar në qytetin e Tepelenës në datat 25-28 maj, zhvilluar nga Qendra Kulturore Tepelenë. Morën pjesë 100 artistë nga të cilët 25 fëmijë. Datë 28.5.2018 përshëndeti këtë projekt edhe Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore. Edukim/sesion shkencor/shfaqje folklorike/panair artizanati dhe kulinarie/shfaqje nga Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore.

5. Projekti i **Festivalit Përmeti Multikulturor 2018**, u organizua nga Seksioni Shqiptar i CIOFF-it në qytetin e Përmetit më datat 21-22-23 qershor 2018. Në këtë festival morën pjesë 9 grupe me 140 artistë pjesëmarrës nga të cilët 15 fëmijë. Pjesëmarrës në këtë festival ishin : Grupi muzikor i ansambilit Teuta Durres me drejtues z Miltiadh Driza, grupin polifonik e instrumental te Mokres me drejtues artistin instrumentit Ramadan Kllogeri që ka përfaqësuar Shqipërinë në dhjetra shtete me këngën e tij, me fyellin e tij legjendar, Grupi polifonik i Malëshoves, Grupi i grave të Dropullit të Sipërm, të cilat percjellin ne breza këngën polifonike, Grupi i komunitetit arumun të Kavajës me drejtues z Todi Buli që sollën në qytetin e Përmetit KARNAVALET që u ndoq me shume vemendje, Grupi muzikor Visaret e Krabes me drejtues z Ilir Selba, Sazet e klarinetistit te ri Krist Konica nga Leskoviku qe po punon per te rigjallëruar keto saze me emer kombetar, Grupi i valleve Syziu Danc me koreograf z. Leonard Syziu qe është nje nga grupet e valleve më të mira në shkallë vendi dhe së fundi Ansamblin SKLIVANI nga qyteti i Janines ne Greqi i cili solli nje masivitet dhe interpretime cilesore. Këtë festival e përshëndetën edhe Kryetari i Bashkisë se qytetit z. Niko Shupuli dhe Ministrja e Kultures znj. Mirela Kumbaro Furxhi.

6.Projekti „**Panairi veror i artizanatit dhe zejtarisë në Velipojë**“ u organizua nga Shoqata e Artizanëve dhe Punimeve Artistike të Shqipërisë në 7 korrik në qytetin e Velipojës. Ky projekt përmbante panair artizanati e zejtarie. U zhvillua në sheshin kryesor të Njësisë Administrative Velipojë në kuadrin e turizmit kulturor. Morrën pjesë 30 artizanë të cilët promovuan punimet e

tyre artistike në dru, gur, baker, xham, avlemend, kostume popullore, instrumenta popullore, etj. Ky panair, orari i të cilit ishte 19.00-24.00, u ndoq nga rreth 5000 vizitorë vendas dhe të huaj.

7. Projekti “**Vera Kulturore Maqedonase**” u organizua nga z. Edmond Sotir në Pustec në 25-30 korrik. Ky projekt përfshiu shfaqje teatrale dhe muzikore folklorike tradicionale të zones, artizanat, kulinari. Morrën pjesë 70 artistë. Gjithashtu morrën pjesë edhe 15 artizanë që promovua vlerat e artizanantit të zones si dhe u promovuan edhe gatimet e zones në panairin e kulinarisë. Aktiviteti u ndoq nga 500-600 spektatorë në natë, me rreth 4000 spektatorë gjithsej.

8. Projekti “**Lirika e divanit lunxhjet**” zhvillohet nga Qendra Rajonale „Syri i Medias së Re“ në fshatin Dhoksat, në 11 gusht. Aktiviteti përbënte shfaqje folklorike, panair agrobiznesi dhe promovim botim. Morrën pjesë në shfaqje Ansambli „Lunxhëria“, Grupi polifonik Cfaqë, Grupi i Fëmijëve të Njesisë Administrative „Asim Zeneli“, Grupi polifonik i të rinjve Tepelenë, Grupi polifonik „Zëri i Birbilit“ Sarandë, Grupi „Gjergj Arjaniti“ Mallakastër, Grupi i vllahëve Kavajë, Ansambli popullor Krrabës, Orkestrinë popullore, grupi i Valleve të Dropullit dhe grupi i Valleve të Janinës, gjithsej 85 artistë. Gjithashtu u promovuan edhe prodhimet e kulinarisë së zonës në panairin e agrobiznesit.

Projekte me Thirrje - EDUKIM :

1. Projekti : “**Edukimi përmes valles tradicionale të brezit të ri**”, zhvillohet nga koreografi Bardhyl Pojani në qytetin e Korçës, periudha Mars-Qershor. Projekti ka filluar në 1 Mars. Morrën pjesë 6 shkolla të mesme të qytetit si "Faik Konica, Ymer Dishnica, Themistokli Germenji, Shkolla T.I.K shkolla e mesme Isuf Gjata dhe shkolla "ekonomike profesionale dhe një shkollë e mesme e Dvoranit. Secili gjimnaz ka pasur interes për mësimin e valleve të ndryshme tradicionale korçare. Rreth 500 nxënës kanë mësuar vallet e zonave të ndryshme të Korçës e më gjerë. Janë zhvilluar 4 performanca artistike në ambiente të ndryshme të shkollave pjesëmarrëse dhe një në fshatin Dvoran ku të rinjtë kanë performuar me kostume popullore.
2. Projekti : “**Edukimi përmes këngës gjirokastrite të brezit të ri**”, zhvillohet nga këngëtari Roland Çenko në qytetin e Gjirokastrës, periudha Mars-Qershor. Projekti nisi në shkollat e qytetit të Gjirokastrës në muajin mars dhe përfundoi në fund të qershorit. Aktivitetet u shtrinë ndërsa shkolla brenda dhe jashtë qytetit, në shkollat 9-vjeçare “Muhamet Gjollësia” Lazarat, “Bilal Golemi” Ura e Kardhiqit, Shkolla Industriale, “Naim Frasheri” Gjirokaster, “Siri Shaplo” Gjirokaster, “Koto Hoxhi”, “Zhuzepe Grassi” dhe në Gjimanazi “Asim Zeneli” Gjirokaster. Në këtë periudhë nxënësit janë aktivizuar në koncerte të ndryshme brenda shkollave të tyre si dhe në bashkëpunimin nëpërmjet shkollave janë organizuar shfaqje të përbashkëta me këngë, valle dhe parada kostumesh. Në këtë projekt morrën pjesë 140 nxënës.
3. Projekti “**Edukimi i fëmijëve përmes trashëgimisë kulturore, materiale dhe jomateriale**”, zhvillohet nga znj. Ariana Todhe në qytetin e Përmetit, në periudhën mars-qershor. Në këtë projekt morrën pjesë 137 nxënës (72 artistë, 18 kulinari dhe 47 në pirografi). **Klubi i artistëve të vegjël** përbëhet, nga grupi i instrumentistëve, i interpretuesve të këngës popullore dhe i këngës për fëmijë, si dhe grupi i valleve. U aktivizuan 72 nxënës nga cikli i ulët dhe atij 9-vjeçar i Shkollës 9-vjeçare „Nonda Bulka“, nga këta djem 32 djem dhe 40 vajza. Më datën 10 prill në palestrën e shkollës u organizua vallzimi sportive i cili u organizua në

formë konkursi me 16 çifte 16 vajza dhe 16 djem. Më 25 maj në kinemanë e qytetit u organizua koncerti me këngë, valle për nxënësit dhe prindrit e shkollës. Më 6 qershor në kuadër të përfundimit të vitit shkollor u dha koncerti në qendër të qytetit të Përmetit. **Grupi i Kulinarisë** fillimisht iu bë thirrje gjithë nxënësve që në bashkëpunim me mamatë dhe gjyshet e tyre të gatuanin në shtëpitë e tyre gatesa tradicionale dhe ti sillnin ato në shkollë dhe ti kosumonin ato së bashku nëpër klasa nën moton “ Të ushqehemi shëndetshëm” duke zëvendësuar kështu ushqimin e përditshëm të blerë nëpër lokale. Produktet më tipike të gatesës përmetare u përzgjodhën dhe me nxënësit përkatës u përfaqësuan si shkollë në panairin e organizuar nga Bashkia Përmet me rastin e ditë së verës me logon “Edhe unë gatuaj si gjyshja” ushqimet e të cilëve u vlerësuan nga qytetarë e shumë të që i provuan. Në këtë event morën pjesë 18 fëmijë 15 vajza dhe 3 djem. Me rastin e përfundimit të vitit shkollor si dhe përfundimit të projektit më datën 6 qershor u organizua dita e përgatitjes së lakrorit nga vetë nxënësit, përgatitja u bë në ambjentet e shkollës dhe në prani të nxënësve dhe mësuesve. Nxënësit u ndanë në katër tavolina me nga katër nxënës dhe përgatitën së bashku 4 lakrorë dhe pasi i poqën në fund nën moton “të ushqehemi shëndetshëm” i konsumuan së bashku, pjesëmarëse ishin 16 vajza. **Grupi pirografisë** e zhvilloi veprimtarinë e kabinetit të fizikë të shkollës 9-vjeçare „Nonda Bulka“ çdo ditë prej orë 12.30 -14.30 sipas dëshirës. Nxënësit të cilët gjetën vehten e tyre në këtë aktivitet vazhduan ta frekuentojnë atë çdo ditë dhe me punimet e tyre më të mira u çel një ekspozitë e cila u vizitua edhe nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë znj. Lindita Nikolla e cila bëri vlerësimet më të mira për të. Gjatë kësaj periudhe u aktivizuan 47 nxënës 30 djem 17 vajza.

4. Projekti **“Së bashku për ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore tek brezi i ri”**, organizuar nga Shoqata “Aks” dhe zhvilluar më 24-25 maj në qytetin e Librazhdit. Morën pjesë rreth 80 artistë të vegjël, si këngëtarë e valltarë. Qëllimi i këtij projekti ishte promovimi i brezi i ri i vlerave të trashëgimisë kulturore, kostumeve popullore si dhe instrumentave popullore. Ky projekt u zhvillua në bashkëpunim me Shkollën e Mesme të Përgjithshme „Ibrahim Muça“ dhe Shkollën e Mesme Dorëz.
5. Projekti **„Simbolika e plisit dhe prodhimeve me teknikat e vjetra artizanale shqiptare“** u zhvillua nga znj. Anila Zajmi në maj-qershor. Projekti përmbante hulumtim artizanati dhe realizim studimi për dijëbërjen artizanale. Eshtë promovuar në Pazarin e Ri në Tiranë si dhe është rrjete sociale dhe TV kombëtare.
6. Projekti **“Rijetëzimi i trashëgimisë së luleve të traditës-ndikon në edukimin e të rinjve dhe turizmin mjedisor”** zhvillohet nga z. Ali Delialaj në qytetin e Përmetit më datë 6.6.2018. Në këtë projekt u zhvilluan ëorkshop, botime broshurash postera promovuese, kulinari, mbjellje lulesh si dhe pastrim mjedisor. Morën pjesë 50 nxënës nga shkollat e qytetit. Ky projekt ndërjegjësoi komunitetin dhe sidomos brezin e ri me traditën e mbjelljes së luleve dhe veçanërisht trendafilin në qytetin e Përmetit si dhe për përdorimin e tij në prodhime kulinare. Aktiviteti u zhvillua në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare „Nonda Bulka“ dhe Gjimnazit Publik „Sami Frashëri“.
7. Projekti **“Takim Brezash”**, organizuar nga Fondacioni “Tradita Popullore” Kashar, zhvilluar në periudhën maj-qershor në qytetin e Tiranës. Ky projekt përfshiu kurse trajnimi për të rinj në dijëbërjen e kostumeve popullore, njohje me teknikat artizanale të qepjes së kostumeve popullore si dhe u organizua një shfaqje folklorike nga nxënës të shkollave të Kasharit. Fondacioni “Tradita Popullore” ka hapur ateljenë më të madhe në vend, e cila do të funksionojë si një qendër multifunkionale në shërbim të turizmit dhe promovimit të vlerave

të trashëgimisë kulturore të vendit tonë. Në këtë atelje ekspozohen veshjet popullore dhe aksesoret tradicionalë nga mbarë trevat shqiptare. Kjo atelje ndodhet pranë Casa Italia, Tiranë. Në këtë projekt morën pjesë 150 nxënës nga tre shkolla : Shkolla e Mesme “Andon Zako Çajupi”, Shkolla e Mesme “Sami Frashëri” dhe Shkolla e Mesme “Qemal Stafa”.

8. Projekti “**Ne dhe trashëgimia kulturore, traditat, legendat pranë shkollës**”, organizuar në qytetin e Tiranës nga Qendra për Promovimin e Konkureshmërisë. Projekti u zhvillua në datë 30 maj në shkollën 9-vjeçare “Misto Mame” në Tiranë. Morën pjesë 150 pjesëmarrës, nxënës, mësues të shkollës, stafi organizator nga Qendra. Kjo veprimtari ishte rezultat i angazhimit prej 2 muajsh të kordinatorëve të projektit që në bashkëpunim me mësuesit e shkollës të letërsisë dhe vizatimit si dhe të klubit të vizatimit u bashkëpunua për të stimuluar nxënësit në mënyrë të drejtpërdrejtë për të hulumtuar në traditën e të parëve të tyre për ta ringjallëruar dhe ta sjellë të freskët mes moshatarëve të tyre vallet dhe legendat e përshkruara, të sjella nga zonat e ndryshme të veriut, në orët e letërsisë. Vizatime të kostumeve dhe qepja e disa kostumeve me aksesore ishin disa kontribute që shtuan fondin e kostumeve popullore të shkollës. Shpresojmë që kjo veprimtari pati ndikim në njohjen e vlerave të trashëgimisë nga kanë prejardhjen nxënësit, vlerësimin për kulturën që kanë krijuar dhe lënë të parët tanë por veçanërisht në trashëgiminë e saj duke përtëritur kulturën e trashëgiminë e zonave të veriut nga origjina e vetë nxënësve.

Projekte të Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës :

1. Realizimi i Ekspozitës me koleksionet e znj. Patricia Nugee, në Muzeun Historik Kombëtar në periudhën 7-12 maj 2018, me rastin e „Vitet Mbarëkombëtar të Gj.K.Skënderbeut“.
2. Projekti i Promocionit : Posteri i numrit jeshil antikorrupsion, Botimi i Ligjit 27/2018 „Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë“, Botimi i Kalendarit të aktiviteteve kulturore 2018, Institucionet e Trashëgimisë kulturore të vizitueshme, me oraret përkatëse në shqip dhe anglisht, Flete palosje për institucionet e trashëgimisë kulturore. Kolonia e piktorëve të vegjël në Këlcyrë, Koncertet e Cirkut në Gjirokastër dhe Aktiviteti i Albania Open në Gjirokastër

Projektet e Trashëgimisë Jomateriale që janë zhvilluar gjatë periudhës Janar-Gusht të vitit 2018.

I.	Aktivitete të raportuara nga DRKK-të; –	28
II.	Aktivitete të raportuara nga IMK; QKIPK; ASHA –	14
III.	Aktivitete të raportuara nga muzetë kombëtarë –	126
IV.	Aktivitete të raportuara nga parqet arkeologjike –	13
V.	Aktivitete kulturore me thirrje të treteve të realizuara-	16
VI.	Aktivitete të raportuara nga institucionet e varësisë në kuadër të programit të Edukimit përmes Kulturës -	84

Gjithsej 281 aktivitete

➤ **Inventarizimi i 5000 objekteve dhe/ose elementeve të trashëgimisë jomateriale dhe pajisja me kartelë teknike**

Objekte të inventarizuara

Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore në përmbushje të misionit të saj për dokumentimin e saktë shkencor të pasurive kulturore, inventarizimin, ruajtjen, katalogimin informatik të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar në databazën kombëtare të pasurive kulturore, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes, me qëllim identifikimin, ruajtjen, studimin, botimin dhe promovimin e tyre, si dhe në zbatim të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të lidhura me të, ka hartuar dhe realizuar “Planin Operacional 2018” duke përcaktuar objektivat dhe produktet bazuar në tre shtylla kryesore:

- A. Krijimi dhe përditësimi i Regjistrimit Kombëtar të Pasurive Kulturore përmes Sistemit Informatik Kombëtar të Administrimit të Pasurive Kulturore
- B. Kontrolli i lëvizjeve të pasurive kulturore, mbikëqyrja dhe monitorimi i respektimit të të drejtave të pronësisë
- C. Antitrafiku i pasurive kulturore (Lufta kundër trafikimit të pasurive kulturore dhe administrimi i databases së objekteve të humbura)

Aktivitete të organizuara nga institucioni për periudhën: Janar-Gusht 2018

1. Janar- Gusht 2018, rezultojnë të regjistruara në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)” - 41.116 objekte në pronësi publike/private .

Është ndërtuar Sistemi për indeksimin e regjistrave themeltar të fondeve muzeore dhe ndërveprimin për hedhjen e të dhënave në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”. Janë digjitalizuar 24 Regjistra themeltar të fondit të Muzeut Kombëtar të Fotografisë “MARUBI”, total 16583 faqe të digjitalizuar dhe indeksuara, 5 Regjistra themeltar ka përfunduar hedhja e të dhënave dhe regjistruar në total **49080** objekte të importuar në sistem, pjesa tjetër në proces.

2. Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.278 dt.16.05.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, është vendosur që Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore është institucioni i vetëm administrues i kësaj databaze, krijuar përmes projektit “**Krijimi i Qendrave të Informimit Publik për Regjistrimin On-Line të Pasurive Kulturore**”, i përfunduar dhe marrë në dorëzim në Shkurt 2018.

Projekti bëri të mundur:

- Krijimin e Sistemit Informatik Kombëtar i Regjistrimit dhe Administrimit të Pasurive Kulturore dhe Bazës së të dhënave shtetërore për regjistrimin e Pasurive Kulturore materiale

dhe jomateriale për të gjitha kategoritë e poseduesve, me qëllim identifikimin, katalogimin, ruajtjen dhe përdorim nga:

- Institucionet Shtetërore, Subjektet Private (Fizike/Juridike) që posedojnë dhe administrojnë Fonde të Pasurive Kulturore në sistemin e trashëgimisë kulturore dhe të turizmit, për krijimin dhe përditësimin e Regjistrimit Kombëtar të Pasurive Kulturore në pronësi publike dhe private, si dhe për administrimin e Inventarit të Fondit Muzeor Kombëtar.
- Shërbimi doganor
-
- në Republikën e Shqipërisë për monitorimin e lëvizjeve dhe të pronësisë së objekteve të pasurive kulturore, në pronësi publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të RSH.
- Policia e Shtetit / Interpoli për shkëmbim informacioni në sistem lidhur me rastet e grabitjeve dhe vjedhjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore në vend, si dhe në rastet e denoncimeve nga Institucionet Ndërkombëtare që operojnë brenda dhe jashtë RSH.
- Publiku për informim mbi procedurat e regjistrimit të pasurive kulturore kombëtare në pronësi private dhe publike, procedurat e lëvizjes brenda dhe jashtë territorit të RSH për objektet trashëgimi kulturore, si dhe për informacion mbi Pasuritë Kulturore Kombëtare.
- Ndërtimin e kabinetit të serverëve në parametra dhe standarde ndërkombëtare.
- Krijimin dhe vënien në funksion dhe strukturë të 6 Qendrave të Informimit Publik për regjistrimin *online* të pasurive kulturore kombëtare pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare, si Zyra rajonale të QKIPK-së për dokumentimin, inventarizimin dhe katalogimin e pasurive kulturore, monitorimin e lëvizjes, si një strategji kombëtare në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore.
- Krijimin e sportelit të shërbimit publik pranë Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore për informacion dhe kryerjen e procedurave të regjistrimit.
- Lehtësimin e procedurave për shërbim publik ndaj qytetarëve lidhur me regjistrimin e veprave të artit dhe të objekteve të trashëgimisë kulturore në pronësi të tyre si dhe publikimin e pasurive kulturore shqiptare.
- Ndërveprimin në Gov-net për ofrim dhe marrje shërbimi.

3. Programi "ART DHE KULTURA"

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 8-mujori 2018		Realizimi 8-mujori 2018			Realizimi në (%) ndaj Buxhetit vjetor sipas Planit të Rishikuar
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj Planit 8-mujorit	
12	08230	600-601	Paga, Sig.Shoq	361,335	42.9 %	345,630	44 %	95.7 %	63.4 %
12	08230	602-606	Shpen.Korrente	151,652	18 %	113,593	14.4 %	74.9 %	51 %
12	08230	231	Shpen.Kapitale	330,000	39.1 %	326,939	41.6 %	99.1 %	72.7 %
			TOTALI	842,987	100%	786,162	100%	93.3 %	64.5 %

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 93.3% ndaj planit për 8 mujorin e 2018. dhe 64.5 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 42.9% të totalit dhe janë realizuar në masën 95.7% ndaj planit për 8 mujorin e 2018 dhe 63.4 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar. Shpenzimet korrente zënë rreth 18% të totalit dhe janë realizuar në masën 74.9% ndaj planit për 8 mujorin e 2018 dhe 51 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar. Shpenzimet kapitale zënë rreth 39.1% të totalit dhe janë realizuar në masën 99.1 % ndaj planit për 8 mujorin e 2018 dhe 72.7 % ndaj Buxhetit vjetor të rishikuar.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në katër produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Kodi i Programit	08230	Emërtimi i programit	Arti dhe Kultura							Komente
Qselimi 1	Politika e programit synon ngritjen, zhvillimin dhe promovimin e sferave kulturore Kombëtare brenda vitit 2020 nepermjet: Përmirësimin në shtimin e infrastrukturës dhe shërbimeve në institucionet kulturore në vend; Ndihjen dhe mbështetjen e gjeneratës së re dhe krijesve në art kulturë duke respektuar barazimin dhe integritetin gjinor në zhvillimin e veprimtarisë artistike të tyre brenda dhe jashtë vendit; Zhvillimin e audiencave dhe edukimin kulturor të shoqërisë, si dhe Edukimin mbi dhe përmes arteve të brezave të rinj. Përfundimin e produkteve kulturore elitare shqiptare në aktivitetet dhe programe ndërkombëtare									
	**Treguesit e performancës/Produktet:									
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit të Performancës/Produktit	Emërtimi i Treguesit të Performancës***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar në vitin korent	Niveli i rishikuar në vitin korent	Niveli i planifikuar për periudhën progresive	Niveli faktik në fund të vitit korent	% e Realizimit të Treguesit të Performancës/Produktit	
Objektivi 1.1	Zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve në institucionet kulturore në vend, nepermjet realizimit të investimeve përmes projekteve të Teatros "Skena e Re" dhe TKOBAP, QKKF dhe rikonstruksionin e 2 Teatrosve Vendetë									
		A	Ndërtimi dhe rikonstruksione infrastrukturale në nivel qendror	484,915	450,000	450,000	330,000	326,938	99%	
Objektivi 1.2	Pasurimin në masën 4 % të programacionit dhe kalendareve artistike në institucionet e artit dhe sektoreve kreative të skenës e pavarur, duke respektuar parimet e barazisë gjinore, krahasuar me vitin 2017									
		B-C	Veprimtari të realizuara me fondet e programit art kulturë sipas prioriteteve dhe integritetit gjinor	733,129	739,149	742,649	493,487	440,174	89%	
Objektivi 1.3	Rritjen e bashkëpunimeve dhe perfaqësimeve të artistit dhe artisteve shqiptar në aktivitetet dhe skenat ndërkombëtare krahasuar me vitin 2017									
		D	Perfaqësimi jashtë vendit në programet komitare, programet e bashkëpunimit, perfaqësimeve në festivale, panairë, rezidenca etj	33,720	25,400	25,400	19,500	19,050	98%	

Produktin (A): Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore

Drejt përfundimit procesi i punës në lidhje me Investimet dhe ndërtime të reja të skenave bashkëkohore, rikonstruksione infrastrukturore në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës si dhe hapësira të reja rikualifikimi;

- Teatri i ri Turbina, me dy skena, dhe platforma multi funksionale arti, (Inaguruar)
- Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit, në proces

Produkti (B): Aktiviteti artistik në 9 institucione qendrore të Artit dhe Kulturës:

Për realizimin e shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar - Gusht 2018, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor, në zbatim të politikave dhe Programit Art-Kulturë 2017-2019, ka vijuar nga puna për arritjen e objektivave bazuar në Planifikimin e Buxhetit afat mesëm si dhe dokumentit që shoqëron atë Deklaratën e Politikës së Programit duke u mbështetur në veprimtarinë e institucioneve qendrore të artit dhe kulturës në vend, sipas fushave të përgjegjësisë për secilin.

1. Teatri Kombëtar i Operës Baletit dhe Ansamblit Popullor
2. Teatri Kombëtar
3. Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahi vogli”
4. Galeria Kombëtare e Arteve
5. Qendra e Realizimit të Veprave të Artit
6. Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave
7. Cirku Kombëtar
8. Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit
9. Biblioteka Kombëtare

Përgjatë gjithë sezonit turistik (maj-gusht) deri më tani janë zhvilluar dhe gjeneruar edhe shumë projekte të tjera të cilat i janë atashuar kësaj axhende;

- Rreth 40 projekte nga Institucionet e varësisë të Art-kulturës;
- 27 festivale të mbështetura financiarisht nga Ministria e Kulturës në kuadër të thirrjes për projekt-propozime në Art, Kulturë dhe Trashëgimi për vitin 2018;
- Mbi 302 shfaqje kulturore;
- Në mbi 106.000 spektatorë dhe audiencë;
- 10 aktivitete multi-kulturore;
- projekte dhe aktivitete të dedikuara programit kombëtar “Edukimi përmes kulturës” në moton “Rreze jemi ne” dhe “Eja në Jug”, “Zërat e Bardhë” dhe Anifest, janë ndjekur nga një audiencë prej mbi 2000-2500 fëmijë prezent të cilët janë argëtuar dhe kanë performuar njëkohësisht;
- 9 shfaqje të zhvilluar nga Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit në Sarandë, Durrës, Vlorë, Himarë, Llogara dhe Gjirokastër, ndjekur nga një audiencë prezente në mbi 64.000 spektatorë.

- 14 shfaqje të zhvilluar nga Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë në Durrës Ksamil, Vlorë, Sarandë, Shëngjin, Dhërmi, Himarë, ndjekur nga një audiencë e rreth 2000 spektatorë të vegjël e të rritur.
- 5 shfaqje të zhvilluara nga Cirku Kombëtar në Krujë, Durrës, Vlorë, Kavajë, Himarë dhe Shfaqje këto që kanë shoqëruar aktivitetin “Maratonën e Këngës”, të mbështetur nga ministria e Kulturës, në të cilën është shënuar një pjesëmarrje shumë e lartë e ndjekësve ne mbi 1000 spektatorë për çdo spektakël;
- 7 mbremje filmike me shfaqje filmash nga AQSHF të realizuara për herë të parë në një skenat më të reja dhe alternative njëkohsisht, në Tarracën e Pallatit të Kulturës në muajt korrik dhe gusht 2018, në bashkëpunim me Insitutin Italian të Kulturës dhe Nouvel-Tulla Art Center. Aktivitetet janë ndjekur nga një audiencë e re kryesisht, mbi 1000 të rinj, profesionistë të fushës dhe të apasionuar.
- 2 aktivitete të GKA ekspozitë e piktorit Edi Hila si dhe Fëmijët dhe Muzeu nga Giada Kuka në kuadër të thirrjes për projekt-propozime në Art, Kulturë dhe Trashëgimi për vitin 2018, ndjekur nga mbi 5000 vizitorë prezent në GKA.

QKKF Turi Veror Kulturor “Ne jemi rreze”, 6 korrik – 6 gusht 2018

- Tre shfaqje për fëmijë/ "Kësulkuqja" nga QKKF në Sarandë - 6 korrik 2018
- "Çufo dhe Tipi, një aventurë në Verdhushka" nga QKKF në Ksamil – 7 korrik 2018
- "Qeni që nuk dinte të lehte" nga QKKF, në Vlorë- 8 korrik 2018
- Tre shfaqje për fëmijë nga QKKF në Durrës – 12 korrik 2018
- Tre shfaqje për fëmijë nga QKKF në Shëngjin- 14 korrik 2018
- Tre shfaqje për fëmijë nga QKKF në Shkodër -21 korrik 2018
- Tre shfaqje për fëmijë nga QKKF në Gjirokastrë- 26 korrik 2018
- Tre shfaqje për fëmijë nga QKKF në Përmet në Ersekë - 27 korrik 2018
- Shfaqje për fëmijë nga QKKF në 27 korrik Erseke – 28 korrik Korçë
- Tre shfaqje për fëmijë nga QKKF në Pogradec- 29 korrik 2018
- Shfaqje për fëmijë nga QKKF në Himarë – 4 gusht 2018
- Shfaqje për fëmijë nga QKKF në Dhërmi – 5 gusht 2018
- Shfaqje për fëmijë nga QKKF në Vlorë – 6 gusht

Cirku Kombëtar:

- Cirku Kombëtar dhe Maratona e Këngës Popullore në Krujë- 30 korrik 2018
- Cirku Kombëtar dhe Maratona e Këngës Popullore në Vlorë-1 gusht 2018
- Cirku Kombëtar dhe Maratona e Këngës Popullore në Kavajë -6 gusht 2018
- Cirku Kombëtar dhe Maratona e Këngës Popullore në Durrës - 8 gusht 2018
- Cirku Kombëtar në Himarë - 9 gusht 2018

TKOBAP

1. "60 vjet histori", Koncert i Ansambllit Popullor në Llogara dhe Vlorë- 22 qershor 2018

2. Grand Koncert Gala - Opera Jeans nga TKOB në Vlorë - 6 korrik 2018
3. Baleti "Monger" nga TKOB në Sarandë- 12 korrik 2018
4. Grand Koncert Gala - Opera Jeans nga TKOB në Durrës- 13 korrik 2018
5. Sokaku i të marrëve nga Ansambli Popullor në Gjirokastër- 18 – 21 korrik 2018
6. Sokaku i të marrëve nga Ansambli Popullor në Sarandë – 22 korrik 2018
7. Sokaku i të marrëve nga Ansambli Popullor në Himarë - 23 korrik 2018
8. Baleti Monger nga TKOB në Vlorë- 27 korrik 2018
9. Baleti Monger nga TKOB në Durrës- 29 korrik 2018

AQSHF

- Shfaqje e tre filmave me temë: Shqipëria 1997 nga AQSHF tek Tulla NOUVELLE, tek Tarraca e Pallatit të Kulturës – 31 korrik 2018
- Shfaqje e filmit La Nave Dolce : Shqipëria 1997 nga AQSHF tek Tulla NOUVELLE, tek Tarraca e Pallatit të Kulturës – 24 korrik 2018
- Shfaqja e Filmit “Dashuria e Fundit” nga AQSHF- 7 gusht 2018
- Shfaqja e Filmit “Dasma e Sakos” nga AQSHF - 14 gusht 2018
- Shfaqja e Filmit “Shembja e Idhujve/Vdekja e Kalit ” nga AQSHF - 21 gusht 2018
- Program me Filma të Animuar nga AQSHF - 28 gusht 2018

GKA:

- Edi Hila: Piktori i Transformimit tek Galeria Kombëtare në Tiranë- 24 maj 2018 - 29 korrik 2018.

Në kuadër të programit Edukimit mbi dhe përmes artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore:

Programi Kombëtar “Edukimi përmes Artit”, vijon puna e grupeve të punës mbi ngritjen e atelieeve, nismave, programeve dhe kalendarëve të edukimit kulturor në nivel kombëtar, të cilat vihen në jetë nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe gjithë institucionet e varësisë art-kulturë-trashëgimi kulturore si dhe në sistemin arsimor në vend. Aktivitetet që realizohen në kuadër të këtij programi kanë target group, brezin e ri, komunitetin e shkollave në nivel kombëtar.

Bazuar në Urdhrin nr. 100 prot, datë 09.02.2018, me objekt për “Ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe njehsimin e një plani veprimi për jetësimin e programit kombëtar “Edukimi mbi dhe përmes Kulturës”, janë në përfundim hartimi / implementimi i dokumenteve si: Plani i Veprimit, Strategjia Kombëtare për Kulturën dhe Programi Kombëtar për Edukimin përmes Kulturës në bashkëpunim me konsulencën më të mirë të Këshillit të Evropës si dhe planin kombëtar të veprimit. Krijimi i këtij dokumenti strategjik do të vijë në zbatim të politikave kulturore, duke

përfshirë në zbatim dhe realizimin e planit të veprimit institucionet publike dhe ato të skenës së pavarur.

Gjithashtu në kuadër të programit edukimi me art e kulturë dhe trashëgimi kulturore është në proces përgatitja për ndërhyrjen në kurrikulat e shkollës nga njëra anë duke përfshirë në çdo institucion arti linjën pedagogjike dhe edukative.

Produkti (C): Aktivitete artistike kulturore të iniciuara nga MK, sipas prioriteteve institucionale dhe integritetit gjinor.

Ministrisë së Kulturës për projekt-propozimet për vitin 2018 u hap thirrja publike më datë 4 dhjetor 2017 dhe u mbyll më datë 12 janar 2018. Pranë Ministrisë së Kulturës u paraqitën 291 projekt-propozime në art-kulturë dhe trashëgimi kulturore, nga të cilat u miratuan 128 projekte fituese.

Kolegjiumi i përbërë me ekspertë të fushave të artit dhe kulturës, si dhe drejtues të zhvillimit të politikave dhe strategjisë kulturore, vlerësoi fitues projekt-propozimet që përputheshin me kriteret e shpallura në udhëzuesin që shoqëroi thirrjen.

- Kriteret kryesore në të cilin u mbështet vlerësimi ishin: projekte me ide novatore, që garantojnë cilësi dhe profesionalizëm në realizim, qëndrueshmëri dhe vazhdimësi, mundësi për rritjen profesionale të artistit, që sjellin zhvillim dhe gjallërim të skenës artistike e kulturore në Shqipëri, rritje të audiencave, shtrirje gjeografike dhe kohore, që dëshmojnë respektimin e të drejtës së autorit, aftësi për të thithur fonde nga burime të tjera, si dhe që janë të përputhshme me prioritetet e Ministrisë së Kulturës: edukimi përmes artit dhe kulturës, përkrahja e të rinjve duke filluar nga potenciali i tyre krijues e deri tek punësimi i tyre, mbështetje dhe zhvillim të turizmit kulturor.

- Kriteria specifike për këtë vit ishin gjithashtu mbështetja e projekteve në kuadër të hartimit të kalendarit të aktiviteteve për vitin e Skënderbeut dhe për Vitin e Trashëgimisë Kulturore Evropiane. Projektet e përzgjedhura do të mbështeten në mënyrë të pjesshme nga Ministria e Kulturës.

Lista e plotë e projekteve të renditura sipas kategorive është si më poshtë vijon:

Projekte fituese të Trashëgimisë Kulturore Jo materiale, 32 projekte.

Projekte fituese të Librit, 23 projekte.

Projekte fituese për Art Kulturë, 73 projekte

Festivale/Aktivitete dhe Edicione, gjatë turizmit kulturor:

1. Pjesë të Identitetit nga Artan Ibërshimi në Vlorë, Korçë, Elbasan 1 – 10 maj 2018
2. A-FestFilm 2018, nga Anifest në Shkodër 16 – 23 maj 2018
3. “Romanca Shqiptare” nga Endri Sina në Tiranë/Korçë 23 maj 2018

4. "ALBAMONO 2018" nga Dhimitraq Orgocka në Voskopojë, Dardhë, Maliq, Pogradec, Korçë 27 Maj 2018 - 4 Qershor 2018;
5. Festivali Ndërkombëtar i Teatrit për Fëmijë "Skënderbeg" nga Shoqata artistike Klaus' Film në Tiranë 28 Maj 2018 - 2 Qershor 2018;
6. Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë nga Shoqata "Shpirti Artistik i Shkodrës" në Shkodër 1 – 3 qershor 2018
7. AME kuartet klarinet nga Petrika Backa në Shëngjin, Velipojë, Lezhë 3 qershor 2018
8. Pogradeci Art Colony 2018 nga Shoqata Antik në Pogradec 9 – 16 Qershor 2018
9. Bienalja Ndërkombëtare e Akuarelit nga Shoqata Kulturore Vizart në Vlorë, Sarandë, Berat, Tiranë, Himarë 19 qershor 2018.
10. Impresione të artit shqiptar nga Ergys Krisiko në Tiranë 20 qershor 2018
11. Zërat e Bardhë nga Creative City në Amfiteatrin e Tiranës dhe në Vlorë – 21 qershor 2018
12. Viva la Musica, Shoqata "Rozafa Expresson" në Shkodër - 21 qershor 2018
13. " Vox Baroque" Edicioni V- 2018 nga Qendra Vox Baroque në Muzeun Etnografik (Berat) Petrolifera (Vlorë), Hani i Pazarit, (Korçë), Pallati i Brigadave dhe Akademia e Shkencave, Tiranë - 24 qershor 2018 dhe 1,3,4,7,8 korrik 2018
14. Festivali Ndërkombëtar i Muzikës së Dhomës nga Arti dhe kultura Italo-Shqiptare në Durrës - 25 Qershor 2018 - 7 Korrik 2018;
15. "Tourismovie" nga TUNNELFILM në Pogradec, Korçë 5 - 6 korrik 2018;
16. Festivali i filmit ballkanik dhe artit kulinar nga Art-Im-Pulse në Pogradec 2 - 7 korrik 2018;
17. Turtle Fest 2018 nga Turtle Fest në Dhërmi/Vlorë 6 - 8 korrik 2018;
18. Projekti "Verë dhe portokalle" 8 korrik: Gjirokaster dhe Libohovë
19. Festivali i Butrintit nga Ress Egnatia 8 - 14 korrik 2018;
20. "First Step Film Fest #5" nga First Step Association në Korçë 17- 21 korrik 2018;
21. Festivali Multi Kulturor Berat-Edicioni V, Berat 19 – 21 korrik 2018;
22. "Za Fest" në Theth 20 – 22 korrik 2018
23. Eja në Jug: shfaqje filmash dhe teatër për fëmijë;
24. "Festival Jazz in Albania & Eorld Music" nga Shoqata "Syri Blu" në Tiranë, Apolloni dhe Fier-24 28 korrik 2018;
25. MIK Festival (Music Festival of Korça) nga Organizata "Njerëz dhe Ide" në Korçë 26 – 29 korrik 2018;

26. "Përtej Kufijve" Duo Koncert nga Gjergji Gaqi në Korçë dhe Shkodër 27, 30 korrik 2018;
27. Festivali "Fabrika e Peizazheve Muzikale" nga Qendra "Gjenerata e Re" në Zvërnec, Vlorë- 28 korrik 2018 dhe "Skena e Re" Art-Turbina- 2 gusht 2018.
28. Maratona e Këngës Popullore në Berat- 17 korrik 2018; Lushnjë - 19 korrik; Elbasan-23 korrik; Krujë - 30 korrik; Vlorë - 1 gusht; Kavajë - 6 gusht; Durrës - 8 gusht; Sarandë -3 gusht, Përmet - 10 gusht; Belsh -13 gusht; Shkodër -15 gusht; Durrës- 16 gusht 2018; Konispol – 26 gusht 2018;
29. Në datë 17.08.2018, kryevepra botërore "Princi i vogël" e shkrimtarit Antoine de Saint-Exupery erdhi për artdashësit nga aktorja e mirënjohur Yllka Mujo, regjisori Armand Bora dhe kompozitori Aulon Naçi në një vend sa alternativ aq dhe të veçantë, në Fontanën

Monumentale të parkut arkeologjik të Orikut. Ky spektakël teatror u zhvillua më datë 17 Gusht, ora 19:00, organizuar nga Drejtoria Rajonale.

Produkti (D): Përfaqësimi në programe dhe evenimente ndërkombëtare

Kultura si pasaporta jonë më e mirë:

Fondi i krijimtarisë artistike në çdo disiplinë të artit vijon të shfaqë interes për skenat ndërkombëtare dhe ndjehet një rritje interesi për bashkëpunime të përbashkëta kulturore si:

1- Letërsia shqipe u prezantua në Panairin e Librit në Lajpcig nga data 15 deri me datë 18 mars prej Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë që është institucioni qendror në hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e politikave në fushën e librit në Shqipëri.

Mbështetja dhe promovimi i letërsisë shqipe jashtë vendit, krijimi i një hapësire dialogu mbarë shqiptar dhe ndërkombëtar në fushën e librit me një vizion të hapur ndaj diversitetit kulturor ishte një nga objektivat kryesore të këtij projekti.

Në këtë panair, letërsia shqipe u prezantua në stendë dhe në katalog përmes thënies së shkrimtarit tonë Ismail Kadare “Letërsia më fali lirinë dhe jo anasjelltas”, me prurjen më të mirë të letrave shqipe në vitet e fundit, me shkrimtarët bashkëkohorë më të vlerësuar me çmime kombëtare dhe ndërkombëtare në tre vitet e fundit, si: Bashkim Shehu, Çmimi Balkanika 2015, Çmimi “Autori i Vitit” 2016, Rudi Erebara, Çmimi European i Letërsisë, 2016, Ildir Azizaj Çmimi “Autori i Vitit” 2017, Çmimi “Autori i Vitit” 2015, Agron Tufa “Autori i Vitit i Panairit të Librit” 2016, Parid Teferici “Autori i Vitit i Panairit të Librit” 2015, Virion Graçi, Çmimi “Autori i Vitit” 2015, Besnik Mustafaj, Çmimi “Libri më i mirë i vitit 2017” në Panairin e Prishtinës, Luljeta Lleshanaku, nominuar për Çmimin Balkanika dhe çmime kombëtare e ndërkombëtare, Romeo Çollaku, Çmimin e BE dhe çmime kombëtare, Ardian Kyçyku, i nominuar për çmimin e autorit të vitit për 2017 si dhe për çmime të tjera kombëtare.

Të ftuar në stendën shqiptare ishin autorët:

Gazmend Kapllani, një shkrimtar shqiptar që jeton prej njëzet vitesh në Greqi e që përmes krijimtarisë së tij zbulon se si totalitarizmi, emigracioni, kufijtë dhe historia ballkanike kanë formuar jetën private dhe narracionin e tij personal.

Thanas Medi, i vlerësuar nga kritika si një penë virtuoze dhe mjeshtër i kompozicionit, i cili në një pjesë të mirë të krijimtarisë vizaton me ngjyra emocionale tablo të jetës së një pakice kombëtare në Shqipëri, si vllahët, si dhe historinë e një brezi që përjetoi ndryshimet e mëdha të viteve nëntëdhjetë.

Manjola Nasi, përkthyesë dhe poete që sjell lirikën urbane dhe imazhiste të brezit më të ri të letërsisë shqipe.

Kalendari ishte hartuar me aktivitetet në vijim:

Më datë 15 mars, ora 11.00 – 12.00, u zhvilluar takimi me temë: Letërsia e re nga TRADUKISTANI, me autorët: Anton Beck, Manjola Nasi (Shqipëri), Bogdan Cosa; në stendën e TRADUKI-t, organizuar nga Traduki, Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë, Instituti Goethe Bukuresht, Fondacioni Kulturor Lihtenshtejn.

2- Përfaqësimi i Shqipërisë në edicionin e 12-të, Balkan Trafik 2018, në Bruksel, që u mbajt në datat 20-23 prill 2018.

Përfaqësimi i Shqipërisë në edicionin e 12-të Festivalit Ndërkombëtar Kulturor “Balkan Trafik” 2018, u mbajt në datat 19-23 prill 2018, në Bruksel, ku mbështetësit institucional ishin Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe përfaqësinë tonë Diplomatike në Bruksel.

Shqipëria për vitin 2018, u përfaqësua nga Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore (AKKVP), me një formacion prej 17 artistësh që përbëhej nga solistët, grupi i valleve, kompleksi vokal dhe orkestra popullore. Ansambli, bazë e orkestrës dhe grupit polifonik së bashku me Hysni Zelën. Formacioni arriti të realizonte një program artistik me nivel të lartë përfaqësimi, me një repertor të pasur e të larmishëm, përmes këngëve dhe valleve duke promovuar më së miri pasurinë më të madhe të folklorit tonë. Në koncerte u performuan vallet më të spikatura të zonave të ndryshme, këngët polifonike deri te formacionet orkestrale në formën e kabasë apo meloditë e pavdekshme të këngës së kultivuar.

3- “Konkursi Mbarëkombëtar i Krijimtarisë Muzikore” Bienale e Artit: 2019

4- Rozafa expressions, Serbi;

5- BJCEM: Puglia Residencë;

6- Filmi Gjirokastra;

7- Diaspora

8- “Terror”, Dramë Teatër Gëzim Kame

Informacion në lidhje me realizimin e pritshëm për vitin 2018

Në kushtet e pamjaftueshmërisë së fondeve për të përmbushur nevojat e domosdoshme mbi funksionimin normal të veprimtarisë së MK dhe për përmbushjen e objektivave për vitin 2018, Ministria e Kulturës ka paraqitur kërkesa të vazhdueshme për shtesë fondesh me shkresë nr.1596 prot. datë 07.03.2018 si dhe shkresë nr.5997 prot.datë 20.07.2018 mbi “Kërkesë mbi buxhetin për vitin 2018”, për konkretisht:

1.Mbështetur në Ligjin nr. 75/214 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, (nga ku paga për roje është minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave) si dhe në zbatim të VKM nr.399, datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” (sipas të cilës paga minimale nga 22,000 lekë bëhet 24.000 lekë dhe për rojet nga 33,000 lekë bëhet 36,000 lekë), për përballimin efekteve financiare si rezultat i ndryshimeve të legjislacionit, MK ka kërkuar shtesë fondesh në zërin në zërin 602 përkatësisht:

- Planifikim Menaxhim, Administrim : 602.....1,477 mijë lekë
- Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë : 602.....30,960 mijë lekë
- Arti dhe Kultura : 602.....15,359 mijë lekë

Në total.....47,797 mijë lekë

2.Duke marrë shkas nga realizimi në fakt i të ardhurave nga institucionet e varësisë për vitin 2017 si dhe në zbatim të udhëzimit të përbashkët nr.52 datë 09.02.2015 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e varësisë të sistemit të Ministrisë së Kulturës”, në zërin 602/5, referuar buxhetit të akorduar për vitin 2018, Ministria e Kulturës ka kërkuar rritjen e taveve mbi përdorimin e fondit të shpenzimeve nga të ardhurat me qëllim përmirësimin e kushteve të institucioneve të artit dhe trashëgimisë përkatësisht:

- Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë: 602/5.....37,568 mijë lekë
- Arti dhe Kultura : 602/5.....2,653 mijë lekë

Në total.....40,221 mijë lekë

3.Në kuadër të përfundimit të projektit Qendra Kombëtare Kulturore “Skena e Re” dhe si rezultat i zhvendosjes së Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental në godinën Skena e re “ArTURBINA” janë kërkuar fonde shtesë në vlerën prej **10,900 mijë lekë**, për të përballuar shpenzimet mbi furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ujë dhe për shërbimin e sigurimit dhe të ruajtjes.

4.Në kuadër të promovimit të Artit Shqiptar në Arenën Ndërkombëtare do të realizohet projekti “Bialja e Venecias e Artit 2019” me synim forcimin dhe konsolidimin e vlerave artistike dhe zhvillimit të diplomacisë kulturore në nivele të larta ndërkombëtare, ku kërkohen fonde në vlerën 15 000 mijë lekë për pagesën e hapsirës ku do qendrojë pavioni shqipëtar përkatësisht:

- Arti dhe Kultura : 604.....15,000 mijë lekë